



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 17

Tiranë – E mërkurë, 2 shkurt 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 3/2022, datë 27.1.2022	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 66/2021, “Për zgjedhjen e Byrosë dhe përbërjen e sekretariateve të Kuvendit”, të ndryshuar..... 1795
Vendim i Kuvendit nr. 4/2022, datë 27.1.2022	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 67/2021, “Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar..... 1795
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 3, datë 31.1.2022	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 26, datë 4.9.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar..... 1795
Urdhër i Agjencisë për Media dhe Informim nr. 32, datë 26.1.2022	Për delegim kompetence..... 1801
Urdhër i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 38, datë 27.1.2022	Për përcaktimin e mënyrës së aplikimit për vendosjen e strukturës së shërbimit në brezin e shërbimeve të stacionit të plazhit..... 1801
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 35, datë 26.1.2022	Për krijimin dhe vënien në funksion të Regjistrat Elektronik të Organizatave Jofitimprurëse..... 1802
Urdhër i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 21, datë 31.1.2022	Për delegim të përkohshëm kompetencash..... 1803
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 9, datë 21.1.2022	Mbi licencimin e shoqërisë “Breçani R.O.S.P.” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Drita” me kapacitet të instaluar 1980 kw..... 1803
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 10, datë 21.1.2022	Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, mbi kërkesën e shoqërisë “Irarba Energi” sh.p.k., për transferimin e asetëve në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë (United Bank of Albania) sh.a..... 1805

Vendim i Entit Rregullator të
Energjisë nr. 11, datë 21.1.2022

Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Lajthiza
Invest” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga
HEC “Qami 1”, me kapacitet të instaluar 1.730 mw.....

1806

Korrigjim gabimi material në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 108,
datë 22.4.2021, “Mbi miratimin e Rregullave të përbashkëta të
shlyerjes për shkëmbimin e energjisë, në përputhje me nenet 50 (3)
dhe 51 (1), të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian
2017/2195”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 78, datë 25.5.2021.....

1809

**VENDIM
Nr. 3/2022****PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 66/2021,
“PËR ZGJEDHJEN E BYROSË DHE
PËRBËRJEN E SEKRETARIATEVE
TË KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës; të neneve 8, 9 dhe 55, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Në pikën II, të vendimit të Kuvendit nr. 66/2021, “Për zgjedhjen e Byrosë dhe përbërjen e sekretariateve të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Deputeti Belind Këlliçi zëvendësohet me deputetin Xhelal Mziu.

2. Deputetja Grida Duma zëvendësohet me deputetin Dashnor Sula.

II. Në pikën III bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Deputetja Flutura Açka zëvendësohet me deputetin Bledion Nallbati.

2. Deputetja Dhurata Çupi (Tyli) zëvendësohet me deputeten Lindita Metaliaj.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 27.1.2022.

**VENDIM
Nr. 4/2022****PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 67/2021,
“PËR CAKTIMIN E KRYESIVE TË
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME
TË KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të neneve 21, pika 1, dhe 55, të

Rregullores së Kuvendit, me propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

Në pikën I, të vendimit nr. 67/2021, “Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

I. Në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut deputetja Dhurata Çupi (Tyli) caktohet zëvendëskryetare në vend të deputetit Oerd Bylykbashi.

II. Në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë deputetja Grida Duma caktohet kryetare në vend të deputetes Albana Vokshi.

III. Në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik deputetja Flutura Açka caktohet kryetare në vend të deputetit Agron Gjekmarkaj.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 27.1.2022.

**UDHËZIM
Nr. 3, datë 31.1.2022****PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN NR. 26, DATË 4.9.2008,
“PËR TAKSAT KOMBËTARE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 26, datë 4.9.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:



1. Në pikën 2 “Taksat kombëtare”, pas paragrafit 2.11 shtohen paragrafët 2.12, 2.13, 2.14, 2.15, 2.16, me këtë përmbajtje:

“2.12 Taksa për importimin dhe prodhimin e qumështit pluhur është në vlerën 100 lekë/kg.

2.13 Taksa për importimin dhe prodhimin e pijeve të homogjenizuara është në vlerën 16 lekë/litër.

2.14 Taksa për importimin dhe prodhimin e hirrës së qumështit është në vlerën 150 lekë/litër.

2.15 Taksa për importimin dhe prodhimin e krem qumështit është në vlerën 150 lekë/litër.

Taksat e përcaktuara në paragrafët 2.12 deri në 2.15 zbatohen si për sasitë e importuara nga personat e tatueshëm, ashtu edhe për sasitë e prodhuara në vend.

Për qumështin pluhur, pijet e homogjenizuara, hirrën e qumështit dhe kremin e qumështit të importuar, importuesi e paguan taksën pranë degëve doganore ku kryhen procedurat e çlirimit për qarkullim të lirë, në momentin e kryerjes së këtyre procedurave.

Për këto produkte të prodhuara në vend, deklarimi dhe pagesa e taksës në administratën tatimore bëhet nga çdo tatimpagues prodhues së bashku me dorëzimin e deklaratës së taksave kombëtare, brenda datës 15 të muajit pasardhës për muajin paraardhës.

Transferimi nga Administrata Doganore i të ardhurave të arkëtuara nga taksa, në llogarinë e të ardhurave të Administratës Tatimore bëhet brenda datës 15 të muajit pasardhës për muajin paraardhës, sipas deklaratës së taksave kombëtare.

2.16 Taksa për lëndën djegëse të përdorur si karburant për mjetet lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi, sipas përcaktimeve të legjislacionit në

fuqi për aktivitetet e turizmit detar, me destinacion përdorimi jashtë ujërave territoriale shqiptare, është në vlerën 40 lekë/litri.

Taksa për lëndën djegëse të përdorur si karburant për mjetet lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi paguhet nga personi i tatueshëm, pranë degëve doganore në momentin e regjistrimit të deklaratës doganore të eksportit ose rieksporit për këtë qellim.”.

2. Në fund të pikës 3 “Përfundime nga taksat kombëtare”, pas paragrafit 4.2, shtohet paragrafi 5 me këtë përmbajtje:

“Përfundohen nga pagimi i taksës për qumështin pluhur, taksës për hirrë qumështi dhe taksës për krem qumështi, fabrikat e prodhimit dhe përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij, të cilat në etiketën e miratuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit kanë të evidentuar sasinë në përqindje të këtyre produkteve që janë trupëzuar në produktin përfundimtar. Kriteret, kushtet dhe procedurat e përfundimit sipas kësaj pike përcaktohen nga udhëzimi i përbashkët i ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për kontrollin ushqimor, referuar pikës 8, të nenit 9, të ligjit “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar.”.

3. Formulari i Deklarimit dhe Pagesave të Taksave Kombëtare, bashkëlidhur udhëzimit, zëvendësohet me formularin bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE
EKONOMISË
Delina Ibrahimaj


**FORMULAR I DEKLARIMIT
DHE PAGESËS TË TAKSAVE
KOMBËTARE**


(2) Periudha tatimore

(1) Numri Serial: _____

Numri i Vendosijes së Dokumentit (NVD)

(Vetëm për përdorim zyrtar)

Numri Identifikues i Personit të Tatueshëm (NIPT): (3)

Emri Tregtar i Personit të Tatueshëm: (4)

Emri Mbiemri i Personit Fizik: (6)

Adresa: (7)

Qyteti/Komuna/Rrethi:

Lajmëroni nëse informacioni i mësipërm është jo i plotë ose ka ndryshuar

Numri Telefonit: _____

(8) Shënoni "x" nëqoftëse gjatë muajit nuk është bërë asnjë transaksion

1. TAKSA E QARKULLIMIT**Deklarim për tatimpaguesit prodhues në vend.**

1.1 Benzinë e prodhuar në vend

[9;10]: 2710 12 41; 2710 12 45; 2710 12 49; 2710 12 51; 2710 12 59 (litra) 27102011, 27102012, 27102013, 27102014, 27102015, 27102016, 27102017, 27102018, 27102019, 27102090, 38 26 00

Sasia e prodhuar

Shuma e taksës

[9]	[10]
-----	------

1.2 Gazoil i prodhuar në vend

[11;12]: 2710 19 31; 2710 19 35; 2710 19 43; 2710 19 46; 2710 19 47; 2710 19 48; (litra) 27102011, 27102012, 27102013, 27102014; 27102015, 27102016, 27102017, 27102018, 27102019, 38 26 00

[11]	[12]
------	------

Deklarim për organet doganore

1.3 Benzinë e importuar

[13;14]: 2710 12 41; 2710 12 45; 2710 12 49; 2710 12 51; 2710 12 59 (litra) 27102011, 27102012, 27102013, 27102014, 27102015, 27102016, 27102017, 27102018, 27102019, 27102090, 38 26 00

Sasia e importuar

Shuma e taksës

[13]	[14]
------	------

1.4 Gazoil i importuar

[15;16]: 2710 19 31; 2710 19 35; 2710 19 43; 2710 19 46; 2710 19 47; 2710 19 48; (litra) 27102011, 27102012, 27102013, 27102014; 27102015, 27102016, 27102017, 27102018, 27102019, 27102090, 38 26 00

[15]	[16]
------	------

2. TAKSA E KARBONIT**Deklarim për tatimpaguesit prodhues në vend**

2.1 Benzinë e prodhuar në vend

[17;18]: 2710 12 41; 2710 12 45; 2710 12 49; 2710 12 51; 2710 12 59 (litra) 27102011, 27102012, 27102013, 27102014, 27102015, 27102016, 27102018, 27102019, 27102090, 38 26 00

Sasia e prodhuar

Shuma e taksës

[17]	[18]
------	------

2.2 Gazoil i prodhuar në vend

[19;20]: 2710 19 31; 2710 19 35; 2710 19 43; 2710 19 46; 2710 19 47; 2710 19 48; (litra) 27102011, 27102012, 27102013, 27102014; 27102015, 27102016, 27102018, 27102019, 27102090, 38 26 00

[19]	[20]
------	------

2.3 Qymyr i prodhuar në vend

[21;22]: 2701; 2702 (kg)

[21]	[22]
------	------

2.4 Vajgur i prodhuar në vend

[23;24]: 27 10 19 11 - 27 10 19 29 (litra)

[23]	[24]
------	------

2.5 Solar i prodhuar në vend

[25;26]: 2710 19 62 deri në 2710 19 68 (kg)

[25]	[26]
------	------

2.6 Mazut i prodhuar në vend

[27;28]: 2710 19 62 deri në 2710 19 68 (kg)

[27]	[28]
------	------



2.7 Koks Naftë i prodhuar në vend

[29; 30;]; 2713 11 00; 271312 00; (kg)

[29]	[30]

Deklarim për organet doganore

2.8 Benzinë e importuar

[31;32]; 2710 12 41; 2710 12 45; 2710 12 49; 2710 12 51; 2710 12 59 (litra) 27102011, 27102012, 27102013, 27102014, 27102015, 27102016, 27102018, 27102019, 27102090, 38 26 00

Sasia e importuar	Shuma e taksës
[31]	[32]

2.9 Gazoi i importuar

[33;34]; 2710 19 31; 2710 19 35; 2710 19 43; 2710 19 46; 2710 19 47; 2710 19 48; (litra) 27102011, 27102012, 27102013, 27102014; 27102015, 27102016, 27102018, 27102019, 27102090, 38 26 00

[33]	[34]

2.10 Qymyr i importuar

[35; 36;]; 2701; 2702 (kg)

[35]	[36]

2.11 Vajgur i importuar

[37; 38;]; 27 10 19 11 - 27 10 19 29 (litra)

[37]	[38]

2.12 Solar i importuar

[39;40]; 2710 19 62 deri në 2710 19 68 (kg)

[39]	[40]

2.13 Mazut i importuar

[41;42]; 2710 19 62 deri në 2710 19 68(kg)

[41]	[42]

2.14 Koks naftë i importuar

[43; 44;]; 2713 11 00; 271312 00 (kg)

[43]	[44]

3. TAKSA E MATERIALEVE PLASTIKE DHE E AMBALAZHEVE
PREJ PLASTIKE/QELQ

Deklarim për tatimpaguesit prodhues në vend të ambalazheve të qelqit

[45;46;]; Ambalazhe boshe (kg)

[47; 48;]; Mallra të ambalazhuara në ambalazh plastik (ambalazh; kg)

[49;50] Ambalazhe plastike nga riciklimi (kg)

Sasia prodh/ shitur	Shuma e taksës
[45]	[46]
[47]	[48]
[49]	[50]

Deklarim për tatimpaguesit prodhues në vend të ambalazheve të qelqit

[51;52] Ambalazhe boshe

[53;54] Mallra të ambalazhuara në ambalazh qelqi (kg, ambalazh)

[51]	[52]
[53]	[54]

Deklarim për organet doganore

[55;56] Materiale /artikuj plastik konsiderohen mallrat e importuara sipas kapitullit 39 të NKM

[57;58] Lëndët e para në format primare të importuara në kërret 3901 deri në 3914 të CNP

[59;60] Ambalazh qelqi të importuar

Sasia e importuar	Shuma e taksës
[55]	[56]
[57]	[58]
[59]	[60]



4. TAKSA MBI PËRDORIMIN E TRUALLIT SHTETËROR

Deklarim i personave pagues të taksës

[61; 62]; Vlera e sipërfaqes së truallit shtetëror në përdorim

Vlera	Shuma e taksës
[61]	[62]

5. TAKSA E MJETEVE TË PËRDORURA TË TRANSPORTIT RRUGOR

Deklarim për agjentin DPSHTRR

[63;64]; Mjete të përdorura të transportit rrugor

Numri i mjeteve	Shuma e Taksës
[63]	[64]

6. TAKSA PORTUALE

Deklarim për Agjentin Kapiteneria e Porteve

- Prekje të portit

[65;66]; Anije shqiptare

[67;68]; Anije të huaja

Nr. prekje	Shuma e taksës
[65]	[66]
[67]	[68]

7. TAKSA E USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË PESHKIMIT

Deklarime për Agjentin Drejtoria e Politikave të Peshkimit

[69;70]; Peshkimi detar

[71;72]; Peshkimi artizanal me mjete të lehta [73;74];

Peshkimi sportiv në det me mjete lundruese [75;76];

Akuakultura

Nr. Lejeve	Shuma e taksës
[69]	[70]
[71]	[72]
[73]	[74]
[75]	[76]

8. TAKSA E AKTEVE DHE E PULLËS

Deklarim për Agjentin Zyrtar e Gjendjes Civile

[77;78] Për certifikatë të lëshuar, për regjistrimin e shtetasve të huaj pas dhënies së shtetësisë shqiptare, për procedurën e ndryshimit të emrit/mbiemrit, mbajtjen e akteve të lidhjes së martesës, për procedurën për veçim/bashkim familjesh të shtetasve

Nr. akteve / dokum	Shuma e taksës
[77]	[78]

9. TAKSA E PRIMIT TË SHKRUAR

Deklarim për Agjentin Shoqëritë e Sigurimit

[79;80]; Primet e shkruar me përjashtim të primeve të sigurimit për produktet e jetës, shëndetit në udhëtim dhe kartonit jeshil

Primi i Shkruar	Shuma e taksës
[79]	[80]

10. TAKSA E REGJISTRIMIT FILLESTAR TË AUTOMJETEVE LUKSOZE

Deklarim për Agjentin D.P.SHT.RR.

[81;82]; Automjete luksoze të transportit rrugor

[81]	[82]

11. TAKSA E PËRVITSHME E AUTOMJETEVE LUKSOZE

Deklarim për Agjentin D.P.SHT.RR.

[83;84]; Automjete luksoze të transportit rrugor

Numri i Automjeteve Shuma e taksës

Numri i Automjeteve	Shuma e taksës
[83]	[84]

**12. TAKSA E QUMËSHTIT PLUHUR**

Deklarim për tatimpaguesit prodhues në vend
[85;86]; 0402 10 19 dhe 0402 21 18 Qumësht

Sasia prodhuar Shuma e taksës

[85]	[86]
------	------

13. TAKSAE PIJEVE TË HOMOGJENIZUARA

Deklarim për tatimpaguesit prodhues në vend
[87;88]; 0404 90 21, 0404 90 23 dhe 0404 90 29
Pije të homogjenizuara

Sasia prodhuar Shuma e taksës

[87]	[88]
------	------

14. TAKSA E HIRRËS SË QUMËSHTIT

Deklarim për tatimpaguesit prodhues në vend
[87;88]; 0404 10 Hirrë qumështi

Sasia prodhuar Shuma e taksës

[89]	[90]
------	------

15. TAKSA E KREM QUMËSHTIT

Deklarim për tatimpaguesit prodhues në vend

[90;91]; 0402 Krem qumështi

Sasia prodhuar Shuma e taksës

[91]	[92]
------	------

Deklarim për organet doganore

[93;94] Qumësht pluhur (sipas kodeve të NKM)

0402 10 19 dhe 0402 21 18

Sasia e importuar Shuma e taksës

[93]	[94]
------	------

[95;96] Pije të homogjenizuara (sipas kodeve të NKM) 0404 90 21,
0404 90 23 dhe 0404 90 29

Sasia e importuar Shuma e taksës

[95]	[96]
------	------

[97;98] Hirrë qumështi (sipas kodeve të NKM) 0404 10

Sasia e importuar Shuma e taksës

[97]	[98]
------	------

[99;100] Krem qumështi (sipas kodeve të NKM) 0402

Sasia e importuar Shuma e taksës

[99]	[100]
------	-------

[101;102] Lëndë djegëse e përdorur si karburant
për mjetet lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi,
(sipas kodeve të NKM)
Kodet e NK : te kreut 2710 , te kreut 3826

Lëndë djegëse e përdorur Shuma e taksës

[101]	[102]
-------	-------

TOTALI I TAKSAVE PËR TU PAGUAR

[103]

,- Deklaroj nën përgjegjësinë time që informacioni i mësipërm është i plotë dhe i saktë.



URDHËR

Nr. 32, datë 26.1.2022

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave, z. Besmir Gjokutaj, zëvendës drejtor i përgjithshëm i Agjencisë për Media dhe Informim, për të gjitha procedurat që lejon ligji, për aq sa është e mundur dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Kompetencat e deleguara do të ushtrohen për periudhën nga data 1.2.2022 deri në datën 31.12.2022.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet z. Besmir Gjokutaj, zëvendës drejtor i përgjithshëm i Agjencisë për Media dhe Informim.

4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Endri Fuga

URDHËR

Nr. 38, datë 27.1.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E MËNYRËS SË
APLIKIMIT PËR VENDOSJEN E
STRUKTURËS SË SHËRBIMIT NË
BREZIN E SHËRBIMEVE TË
STACIONIT TË PLAZHIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të germës “ç”, të pikës 7, të nenit 14, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 171, datë 27.3.2019, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”, të ndryshuar, dhe të pikës 1/1, të nenit 41, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Përcaktimin e mënyrës së aplikimit për vendosjen e strukturës së shërbimit në brezin e shërbimeve të stacionit të plazhit, për subjektet e parashikuara në shkronjën “ç”, të pikës 7, të nenit 14, si më poshtë vijon:

a) Subjekti aplikon në portalin *e-Albania* për vendosjen e strukturës së shërbimit në brezin e shërbimeve të stacionit të plazhit, sipas përcaktimit të germës “ç”, të pikës 7, të nenit 14, të vendimit nr. 171, datë 27.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”, të ndryshuar, njëkohësisht me kërkesën për menaxhimin e stacionit të plazhit;

b) Sipërfaqja e lejuar e strukturës së shërbimit mund të jetë deri në 10 (dhjetë) % të të gjithë sipërfaqes së miratuar të stacionit të plazhit, por, në çdo rast, nuk mund të tejkalojë sipërfaqen totale prej 60 (gjashtëdhjetë) m²;

c) Subjekti, kur bën kërkesën për menaxhimin e stacionit të plazhit, duhet të ngarkojë në momentin e aplikimit në portalin *e-Albania* edhe projektin arkitektonik, shoqëruar me relacionin përkatës, si dhe foto të zonës ku kërkohet të ndërtohet struktura e shërbimit;

ç) GTSHA-ja, kur konstaton se subjekti ka mungesë apo paqartësi dokumentacioni, njofton menjëherë subjektin për plotësimin e tij nëpërmjet portalit *e-Albania*;

d) Në rast se nga GTSHA-ja vlerësohet se subjekti plotëson kriteret dhe dokumentacionin e përcaktuar në pikat 7 dhe 9, të nenit 14, të VKM-së nr. 171/2019, të ndryshuar, subjekti njoftohet, nëpërmjet portalit *e-Albania*, që të aplikojë pranë KKT-së, nëpërmjet sistemit *e-leje*, për miratimin e lejes së ndërtimit për vendosjen e strukturës së shërbimit, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit;

dh) Subjekti, pasi merr vendimin me kusht të miratuar nga KKT-ja, bashkëpunon me njësinë përkatëse të vetëqeverisjes vendore për të negociuar mbi sipërfaqen konkrete që merr në përdorim, brenda parcelës së miratuar për përdorim si stacion plazhi, përfshirë edhe brezin e shërbimeve, sipas rastit, dhe ngarkon në sistem dokumentacionin shtesë, të përcaktuar në



paragrafët “c.i”, “c.ii” dhe “c.ii/1”, të pikës 10, të nenit 14, të VKM-së nr. 171/2019;

e) Pas verifikimit të plotësimit të të gjithë kërkesave të përcaktuara më sipër, GTSHA-ja miraton aplikimin e subjektit për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi, nëpërmjet portalit *e-Albania*, dhe AKB-ja njofton menjëherë subjektin dhe NJVV-në për nënshkrimin e kontratës, sipas formatit tip, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1172, datë 24.12.2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 171, datë 27.3.2019, të Këshillit të Ministrave, ‘Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’, të ndryshuar”;

ë) Para nënshkrimit të kontratës, subjekti duhet të paraqesë marrëveshjen e noterizuar me vrojtuesin e plazhit (shoqëruar me certifikatën përkatëse të kualifikimit), e vlefshme përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, si dhe vendimin me kusht të KKT-së për miratimin e stacioneve të plazhit;

f) Në përfundim të nënshkrimit të kontratës subjekti pajiset me certifikatën e përdorimit të stacionit të plazhit, e cila lëshohet nga ministri përgjegjës për turizmin;

g) Kontrata e nënshkruar ngarkohet nga subjekti në sistemin *e-leje*, si kusht për vijimin e procedurës për lëshimin e dokumentit të lejes së ndërtimit, në përputhje me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

2. Subjektet që kërkojnë lidhjen e kontratave për ushtrimin e veprimtarisë së stacioneve të plazheve ose që kanë nënshkruar kontratat për ushtrimin e veprimtarisë së stacioneve të plazheve para miratimit të këtij urdhri, sipas shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 7, të nenit 14, të VKM-së nr. 171/2019, në rast se kërkojnë vendosjen e strukturës së shërbimit, në brezin e shërbimeve të stacionit të plazhit, të përcaktuara sipas pikës 4, të nenit 9, të vendimit nr. 171, datë 27.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”, të ndryshuar, nuk ndjekin procedurën e përcaktuar në këtë urdhër. Këto subjekte aplikojnë direkt pranë KKT-së për miratimin e lejes së ndërtimit, për vendosjen e strukturës së shërbimit në brezin e shërbimeve të stacionit të plazhit.

3. Ngarkohen GTSHA-ja, Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT
DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro Furxhi

VENDIM
Nr. 35, datë 26.1.2022

**PËR KRIJIMIN DHE VËNIEN NË
FUNKSION TË REGJISTRIT
ELEKTRONIK TË ORGANIZATAVE
JOFITIMPRURËSE**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 61, pika 1, shkronja “ë”, dhe në neni 97, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika 2, dhe në neni 52, pika 3, të ligjit nr. 80/2021, “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”,

VENDOSI:

1. Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë krijohet Regjistri Elektronik i Organizatave Jofitimprurëse.

2. Funksionimi i regjistrit elektronik fillon në datën 30 dhjetor 2023.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN
E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami

**URDHËR****Nr. 21, datë 31.1.2022****PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM
KOMPETENCASH**

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 21, shkronja “a”, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 30, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, për shkak të mungesës në punë, për arsye objektive, të Kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së përfaqësimit të institucionit në marrëdhëniet me palët e treta znj. Laerta Rooze, Sekretare e Përgjithshme e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

2. Delegimin e kompetencës së mësipërme për periudhën 31.1.2022–4.2.2022.

3. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, znj. Laerta Rooze.

4. Znj. Laerta Rooze nuk mund ta nëndelegojë këtë kompetencë.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Albana Shtylla**

VENDIM**Nr. 9, datë 21.1.2022**

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“BREÇANI R.O.S.P.” SHPK NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA HEC
“DRITA” ME KAPACITET TË
INSTALUAR 1980 kw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e

energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.1.2022, mbasi shqyrtoi relacionet e përgatitura nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 164/9 prot., datë 11.1.2022 dhe nr. 164/9-1 prot., datë 18.1.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Breçani R.O.S.P.’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Drita’ me kapacitet të instaluar 1980 kw”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 260, datë 21.12.2021, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Breçani R.O.S.P.” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për një afat 30-vjeçar.

Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE, me shkresën nr. 6/30 prot., datë 22.12.2021, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 7.1.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla. Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Më datë 6.1.2022, u zhvillua një seancë dëgjimore me shoqërinë “Breçani R.O.S.P.” sh.p.k., ku u qartësua/sqarua mungesa e pjesshme apo e munguar e dokumentacionit të konstatuar si i tillë nga ERE. Në seancë nga subjekti u bë me dije se ndërtimi i HEC ka përfunduar, janë kryer testimet dhe kolaudimi dhe pret fillimin e operimit. Duke qenë se subjekti ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar nga “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, ka përfunduar punimet e veprës dhe ka parashikuar të fillojë punë në 6 ditët



e para të janarit 2022, (pavarësisht se për këtë afat ka qenë e pamundur të merrej një vendim përfundimtar, për arsye se ishte parashikuar dhe seanca përkatëse me subjektin), është vlerësuar që të vijohet me licencimin e shoqërisë.

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit, në fazën përfundimtare të procedurave të licencimit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “Breçani R.O.S.P.” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson tërësisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat: “a”, “b”, “c”, plotësuar;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, plotësuar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, plotësuar;

- dokumentacioni teknik për HEC, neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, germat: “a”, “b”, “c”, “d”; pika 4.1.4, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, plotësuar;

- leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.1.5, germat: “a”, “b”, “c”, plotësuar.

- Shoqëria “Breçani R.O.S.P.” sh.p.k. të paraqesë në ERE, çdo vit, rinovimin e kontratës nr. 2693/5 prot., datë 18.7.2018, të lidhur ndërmjet Bashkisë Tropojë, në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë “Breçani R.O.S.P.” sh.p.k. në cilësinë e qiramarrësit, në zbatim të nenit 3, pika 1, e kontratës së qirasë e cila orienton afatin 10-vjeçar të kontratës së qirasë me të drejtë rinovimi çdo vit.

- Në përfundim të afatit të vlefshmërisë së lejes për përdorimin e burimit ujor (data 10.12.2023), shoqëria duhet të depozitojë lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujor në ERE, jo më vonë se një muaj pas rinovimit të saj.

- Shoqëria “Breçani R.O.S.P.” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE certifikatën e pronësisë për tokën shtet, me kartelën shoqëruese, me shënimin përkatës për zonën që do të jetë në përdorim të shoqërisë, për ushtrimin e veprimtarisë së HEC “Dritës”, jo më vonë se një muaj nga pajisja me këtë dokument.

- Sa i takon provave të reja apo objeksioneve të mundshme që mund të kenë palë të treta në lidhje me këtë proces, kjo është e adresuar në dispozitivin e këtij vendimi, ashtu si dhe plotësimi/

mosplotësimi i kushteve të vendosura në këtë dispozitiv.

- Sikurse kemi cituar edhe më sipër, kontrata nr. 98 rep., nr. 24/3 kol., datë 16.1.2019, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Drita’ me kapacitet 1.980 mw, në lumin e Gashit, degë e lumit Valbonë, Bashkia Tropojë, qarku Kukës”, lidhur midis MIE-s dhe mbajtësit të miratimit, shoqërisë “Breçani R.O.S.P.” sh.p.k., ka një afat 49-vjeçar, por nga ana tjetër shpjegojmë se ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Breçani R.O.S.P.” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Drita”, me kapacitet të instaluar 1980 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria “Breçani R.O.S.P.” sh.p.k. duhet të paraqesë në ERE, çdo vit, kontratën nr. 2693/5 prot., datë 18.7.2018, të rinovuar, brenda datës 18 gusht të çdo viti, deri në përfundim të afatit 10-vjeçar që ajo përcakton.

3. Shoqëria “Breçani R.O.S.P.” sh.p.k., në përfundim të afatit të vlefshmërisë së lejes për përdorimin e burimit ujor (data 10.12.2023), duhet ta depozitojë atë në ERE, jo më vonë se një muaj pas rinovimit.

4. Shoqëria “Breçani R.O.S.P.” sh.p.k. të depozitojë në ERE certifikatën e pronësisë për tokën shtet, me kartelën shoqëruese, me shënimin përkatës për zonën që do të jetë në përdorim të shoqërisë, për ushtrimin e veprimtarisë së HEC “Drita”, jo më vonë se një muaj nga pajisja me këtë dokument.

5. Ky vendim është objekt rishikimi nga Bordi i ERE-s, sipas përcaktimeve të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të përcaktuara në pikat 2, 3 dhe 4, të këtij vendimi.



6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 10, datë 21.1.2022

**MBI ZGJATJEN E AFATIT TË
VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-
s, MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“IRARBA ENERGJI” SHPK, PËR
TRANSFERIMIN E ASETEVE NË
FAVOR TË BANKËS SË BASHKUAR TË
SHQIPËRISË (UNITED BANK OF
ALBANIA) SHA**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.1.2022, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 63 prot., datë 13.1.2022, dhe relacionin nr. 63/1, datë 18.1.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë ‘Irarba Energji’ sh.p.k. për transferimin e aseteve në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë (United Bank of Albania) sh.a.”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 225, datë 9.11.2021, vendosi të fillojë procedurën, për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Irarba Energji” sh.p.k., për transferimin e aseteve të paluajtshme në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë (United Bank of Albania sh.a.).

- Në nenin 10, pika 2, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit nr. 119, datë 21.7.2016, parashikohet si vijon:

“2. Në rast se dokumentacioni nuk është dërguar konform nenit 7, por është marrë vendim për fillimin e procedurave të shqyrtimit, afati i përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, do të fillojë nga dita e paraqitjes së plotë të dokumentacionit të kërkuar nga ERE. Nëse pas marrjes së vendimit informacioni nuk dërgohet brenda 2 muajve, atëherë vendimi për fillimin e procedurave e humbet fuqinë juridike dhe i licencuari do të paraqesë një kërkesë të re në ERE.”.

- ERE ka njoftuar shoqërinë, për fillimin e procedurave, për shqyrtimin e kërkesës së saj, për transferimin e aseteve, me shkresën e datës 10.12.2021. Duke marrë në konsideratë kohën që i nevojitet postës, përlllogaritet që shoqëria të ketë marrë dijeni për vendimin më datë 12.12.2021.

- Referuar parashikimeve të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, afati dymujor përfundon më datë 12.2.2022.

- Duke qenë se në dokumentacionin e depozituar nga subjekti nuk është e qartë natyra e marrëveshjes/marrëveshjeve me bankën mbi këtë transferim dhe me qëllim koordinimin e listës së aseteve që do të transferohen, duke marrë në konsideratë të gjitha afatet që nevojiten për vendosjen e komunikimit me shoqërinë apo zhvillimit të një seance dëgjimore, për të sqaruar këtë dokumentacion, afatin për të njoftuar shoqërinë për seancën, afatin që i nevojitet shoqërisë për të plotësuar sa kërkuar, afatin për të shqyrtuar dokumentacionin që mund të depozitohet shoqëria, periudhën kohore që i nevojitet Bordit të ERE-s për të shqyrtuar praktikën e më pas të shprehet, në mbështetje të nenit 67, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, vlerësohet zgjatja e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “Irarba Energji” sh.p.k., me 30 (tridhjetë) ditë pune, duke filluar ky afat nga data 12.2.2022.



- Brenda këtij afati do të saktësohet/qartësohet dokumentacioni me shoqërinë “Irarba Energji” sh.p.k., nëpërmjet zhvillimit të një seance të mundshme dëgjimore ose komunikimit shkresor nëse do të jetë e nevojshme në vijim të seancës dëgjimore.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 30 (tridhjetë) ditë pune afatin e vendimmarrjes, mbi kërkesën e shoqërisë “Irarba Energji” sh.p.k., për transferimin e aseteve në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë (United Banka of Albania) sh.a., duke filluar ky afat nga data 12.2.2022.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 11, datë 21.1.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “LAJTHIZA INVEST” SHA NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA HEC “QAMI 1”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1.730 mw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të

datës 21.1.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 98 prot., datë 18.1.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Lajthiza Invest’ sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Qami 1’, me kapacitet të instaluar 1.730 mw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Lajthiza Invest” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 11 prot., datë 5.1.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Qami 1”, në përroin e Srriqës, Satrave dhe Valës, degë të përroit të Srriqës, i cili ndodhet në anën e majtë të lumit Drin, qarku Kukës.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Lajthiza Invest” sh.a. rezulton se shoqëria ka plotësuar kryesisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si më poshtë:

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germa “f”, plotësuar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat: “a”, “b”, “d”, plotësuar;

- dokumentacioni teknik për HEC, neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, germat “a” dhe “d”, plotësuar;

- dokumentacioni tekniko-ekonomik, neni 9, pika 4.1.4, germat: “a”, “c”, “d”, “f”, plotësuar;

- leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.1.5, germat “b” dhe “c”, plotësuar.

- Dokumentacioni i plotësuar pjesërisht apo i munguar ka të bëjë me:

- formatin dhe dokumentacionin për aplikim, neni 9, pika 1:

- germa “a” (të dhëna për aplikimin), shoqëria duhet të plotësojë formatin e aplikimit në të gjithë zërat e tij, së bashku me llojin e aplikimit;

- germa “b” (të dhëna identifikuese për aplikuesit), shoqëria duhet të plotësojë formatin e aplikimit në të gjithë zërat e tij;



- germa “c” (të dhëna për aplikuesin), shoqëria duhet të depozitojë të plotësuar formatin për këtë pikë të rregullores;

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2:

- germa “a”, “b” (akti i themelimit/statuti), shoqëria ka depozituar aktin e themelimit të shoqërisë, të hartuar në momentin e themelimit të saj, dhe një statut të shoqërisë, që edhe pse nuk ka datën e nënshkrimit, në nenet e tij rezulton se është bazuar në legjislacionin për shoqëritë tregtare të vitit 2008, që është disa vite më vonë se akti i themelimit dhe nuk është nënshkruar nga të njëjtat palë themeluese të shoqërisë, ndaj shoqëria duhet të informojë ERE-n për sa depozituar dhe kronologjinë e këtyre akteve të brendshme të funksionimit të saj;

- germa “c” (vërtetimi për regjistrim dhe ekstrakt historik nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)), shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin për regjistrimin dhe ekstraktin historik të plotë;

- germa “d” (vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj në rastin e personave juridik, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata)), shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimet e prokurorisë dhe gjykatës, për administratorin dhe vetë shoqërinë, për të gjitha vendet e ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë;

- germa “e” (struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse. Në rastin e aplikimeve për licencë prodhimi të energjisë elektrike kërkohet paraqitja e licencës për drejtues teknik-elektrik), shoqëria duhet të përcjellë strukturën e ndërtimit dhe licencën e drejtuesit teknik, sipas kërkesave të kësaj pike të rregullores;

- germa “g” (dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (certifikata pronësie, kontrata shit-blerjeje, kontrata qiramarrje, akte dhurimi, kontrata premtim shit-blerjeje, marrëveshje me subjekte private ose shtetërore që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti për ato veprimtari që përdorin asete të paluajtshme etj.)), shoqëria duhet të përcjellë në ERE dokumentacionin përkatës të vlefshëm në lidhje me pronësinë në të gjithë zonën ku do të shtrihet projekti, pasi kontratat e depozituara prej saj e kanë humbur vlefshmërinë. Po ashtu, shoqëria të bëjë me dije nëse kontrata me

MIE-n është regjistruar në zyrën përkatëse të regjistrimit të pasurive, e nëse po, të depozitojë dokumentacionin përkatës, me qëllim që të verifikohet i gjithë dokumentacioni pronësor dhe koordinatat përkatëse të shtrirjes së projektit për ndërtimin e HEC “Qami 1”;

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 3:

- germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera etj.)), shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin përkatës për aftësinë apo mbështetjen financiare, sipas kërkesave të kësaj pike të rregullores;

- Dokumentacionin teknik dhe grafik, neni 9, pika 4.1.3:

- germa “b” (një diagram elektrike në format A1 të aggregateve dhe bllokut të transformimit ku të evidentohen qartë pika e lidhjes me sistemin dhe pika e matjes), shoqëria duhet të depozitojë diagramin elektrike përkatës për HEC “Qami 1”;

- germa “c” (shtrirja gjeografike e vendit ku do të ngrihet apo zhvillohet veprimtaria, duke dhënë referencat ekzakte (numër parcele, numër regjistri kadaestre) të paraqitura në hartë me shkallë 1: 25000), shoqëria duhet të depozitojë këtë dokument, sipas kërkesave specifike të kësaj pike të rregullores;

- Dokumentacionin tekniko-ekonomik, neni 9, pika 4.1.4:

- germa “a” (studimi i fizibilitetit teknik bazuar në të dhëna dhe matje reale të kryera në zonat e zbatimit të projekteve, ku të përfshihen: përshkrim i përgjithshëm i projektit, kushtet klimatike dhe meteorologjike për zonën e projektit sipas tipit të centralit; përshkrimi teknik i zgjedhjes së çdo elementi të centralit bazuar në të dhënat e mësipërme; llogaritjet në të cilat bazohen përzgjedhjet e kryera; studimi, llogaritjet dhe përzgjedhjet e pajisjeve për lidhjen me sistemin dhe transmetimin e energjisë; studim dhe analizë e kushteve gjeologjike-inxhinierike të zonës ku zbatohet projekti), shoqëria duhet të përcjellë në ERE studimin e fizibilitetit, sipas kërkesave specifike të kësaj pike të rregullores;

- Lejen nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.4.5:



- germa “a” (miratimin e OST-së ose OSSH-së për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të transmetimit ose shpërndarjes), shoqëria duhet të përcjellë në ERE miratimin përkatës për lidhjen e centralit me rrjetin elektrik.

- Shoqëria ka bërë me dije se parashikonte fillimin e operimit në datën 15.9.2021, ndërkohë që nuk është pajisur ende me licencë nga ERE, e po ashtu nuk ka ndonjë dokument tjetër apo informacion nga ana e shoqërisë në lidhje me fazën në të cilën ndodhet ndërtimi i HEC. Për këtë arsye shoqërisë do t'i kërkohet të depozitojë lejen e ndërtimit, të bëjë me dije ERE-n nëse kanë filluar punimet e HEC dhe nëse po, fazën në të cilën ndodhen ato. Në rast se punimet kanë përfunduar dhe impianti është kolauduar apo testuar, atëherë do t'i kërkohet shoqërisë që të depozitojë në ERE aktin e kolaudimit apo testimit.

- Referuar raportit të oponencës teknike të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), të depozituar nga shoqëria, rezulton se vlera totale e investimit sipas projektit të zbatimit nuk përkon me vlerën e investimit të përcaktuar në kontratën nr. 2856 rep., nr. 1350/1 kol., datë 22.12.2017, të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Në këto rrethana shoqëria duhet të bëjë me dije ERE-s se ku qëndron ky ndryshim në vlerën e investimit.

- Dokumentacioni i depozituar nga shoqëria për qëllim të këtij aplikimi është në formatin fotokopje, ndaj do t'i kërkohet shoqërisë, që në zbatim të nenit 8, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, të depozitojë këtë dokumentacion dhe atë të munguar apo të plotësuar pjesërisht në versionin origjinal ose fotokopje të noterizuar, brenda afateve të përcaktuara në rregulloren e sipërcituar.

- Në dosjen e aplikimit është depozituar dhe dokumentacioni që i referohet Stabilimentit të Ujit Lajthiza apo ndërtimit të nënstacionit 110/20 kV “Lajthiza”. Vlerësohet që në vijim do të saktësohet/sqarohet me shoqërinë se dokumentacioni që duhet plotësuar, në lidhje me këtë aplikim, duhet të lidhet me centralin HEC “Qami 1”.

- Kontrata nr. 2856 rep., nr. 1350/1 kol., datë 22.12.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe

administrimin e hidrocentralit ‘Qami 1’, me kapacitet 1.730 mw, në përroin e Srriqës, Satrave dhe Valës, degë të përroit të Srriqës, i cili ndodhet në anën e majtë të lumit Drin, qarku Kukës”, lidhur midis MIE-s dhe mbajtësit të miratimit, shoqërisë “Lajthiza Invest” sh.a., ka një afat 49-vjeçar, ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Lajthiza Invest” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Qami 1”, me kapacitet të instaluar 1.730 mw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 108, datë 22.4.2021, “Mbi miratimin e ‘Rregullave të përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë, në përputhje me nenet 50 (3) dhe 51 (1), të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 78, datë 25.5.2021, bëhet korrigjimi duke shtuar materialin bashkëlidhur:

Të gjitha propozimet e TSO-ve kontinentale evropiane për rregullat e shlyerjeve të përbashkëta, për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të kontrollit të frekuencave dhe periudhës së ndryshimit (rritje/ulje), në përputhje me nenin 50 (3), i Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, të 23 nëntorit 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike

Përmbajtja

Parathënie

Shkurtime

Neni 1 Objekti dhe qëllimi

Neni 2 Përkufizime dhe interpretimi

Neni 3 Projekti i nivelit të lartë për shlyerjen e përbashkët

Neni 4 Zbatimi i shlyerjes së përbashkët

Neni 5 Funksionet e shlyerjes së përbashkët

Neni 6 Periudha e shlyerjes

Neni 7 Përcaktimi i volumit për periudhën e shlyerjes TSO–TSO

Neni 8 Rregullat e tarifimit për shkëmbimet TSO–TSO brenda SA CE

Neni 9 Botimi dhe zbatimi i CCFR

Neni 10 Gjuha

Të gjitha TSO-të e Evropës Kontinentale, marrin në konsideratë sa më poshtë vijon:

Parathënie

1. Ky dokument është një propozim i përbashkët i zhvilluar nga të gjithë Operatorët e Sistemit të Transmisionit në Zonën Sinkronike të Evropës Kontinentale (në vijim referuar si “TSO të CE”) në lidhje me zhvillimin e rregullave të përbashkëta të shlyerjes për të gjitha shkëmbimet e

qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të kontrollit të frekuencës dhe periudhës së ndryshimit (rritje/ulje) (në tekstin e mëposhtëm “energji e procesit të kontrollit të frekuencës dhe energji e periudhës së ndryshimit (rritje/ulje)”) në përputhje me nenin 50 (3), të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, të 23 nëntorit 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike (në tekstin e mëposhtëm “EBGL”). Ky propozim më poshtë quhet “CCFR”, i cili nënkupton ‘rregullat e përbashkëta të shlyerjes për Evropën Kontinentale për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të kontrollit të frekuencës dhe periudhës së ndryshimit (rritje/ulje)’.

2. Kjo CCFR merr parasysh parimet dhe qëllimet e përgjithshme të përcaktuara në EBGL, si dhe Rregulloren (EC) nr. 714/2009, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 13 korrik 2009, mbi kushtet e aksesit në rrjet për shkëmbimet ndërkufitare të energjisë elektrike (më poshtë “Rregullorja për Energjinë Elektrike”), si dhe Rregullorja (KE) nr. 2017/1485, e datës 2 gusht 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike (më poshtë referuar si “SOGI”). Qëllimi i EBGL-së është integrimi i tregjeve të balancimit të energjisë. Integrimi i tregjeve të balancimit të energjisë duhet të lehtësohet me krijimin e platformave të përbashkëta Evropiane për operimin e procesit të netimit të disbalancave dhe mundësimin e shkëmbimit të energjisë balancuese nga rezervat e restaurimit të frekuencave dhe rezervat zëvendësuese. Bashkëpunimi midis TSO-ve duhet të kufizohet rreptësisht në atë që është e nevojshme për dizajnimin, zbatimin dhe funksionimin efikas dhe të sigurt të këtyre platformave Evropiane.

3. Nenet 50 (3) dhe 50 (8), të EBGL-së përcakton afatin për dorëzimin e CCFR tek ERE dhe disa kërkesa specifike për përmbajtjen e tyre:

“3. Tetëmbëdhjetë muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, të gjitha TSO-të që shkëmbejnë energji në mënyrë të qëllimshme në një zonë sinkron duhet të zhvillojnë një propozim për rregullat e përbashkëta të shlyerjes të zbatueshme për të gjitha shkëmbimet e qëllimshme të energjisë, si rezultat i një ose të dyja pikave si në vijim:

a) procesit të kontrollit të frekuencës sipas nenit 142, të rregullores (BE) 2017/1485;



b) periudhës së ndryshimit (rritje/ulje) sipas nenit 136, të rregullores (BE) 2017/1485.

.....

8. Të gjitha TSO-të do të krijojnë një mekanizëm të koordinuar për rregullimet e shlyerjeve ndërmjet tyre.”.

4. CCFR-ja kontribuon në objektivin e mosdiskriminimit dhe transparencës në balancimin e tregjeve në pajtim me nenin 3 (1) (a) dhe nenet 3 (2) (a) dhe 3 (2) (b) të EBGL-së, të njëjtat rregulla të shlyerjes do të zbatohen në të gjithë Zonën Sinkronike të Evropës Kontinentale dhe ato do të jenë në dispozicion të publikut.

5. CCFR-ja kontribuon në objektivin e rritjes së efikasitetit të tregjeve Evropiane dhe kombëtare të balancimit, në përputhje me nenin 3 (1) (b) të EBGL-së, duke qenë se programi i kompensimit zëvendësohet me rregullat e përbashkëta të shlyerjes të zbatueshme për të gjithë Zonën Sinkronike të Evropës Kontinentale.

6. CCFR-ja i shërben kërkesës së nenit 3 (2) (h) të EBGL-së duke qenë se kuadri teknik i propozuar bazohet në standardet evropiane të miratuara që tashmë janë në veprim.

7. CCFR-ja u zhvillua duke marrë parasysh konsistencën me rregullat e shlyerjes së shkëmbimeve të paqëllimshme të energjisë brenda Zonës Sinkronike të Evropës Kontinentale në përputhje me nenin 51(1) të EBGL-së.

8. CCFR u zhvillua duke marrë parasysh konsistencën me rregullat e shlyerjes së shkëmbimeve të qëllimshme të energjisë brenda zonave sinkronike në përputhje me nenin 50 (4) të EBGL-së dhe të shkëmbimeve të paqëllimshme në përputhje me nenin 51 (2) të EBGL-së.

9. Në përfundim, CCFR kontribuon në objektivat e përgjithshme të EBGL-së.

Shkurtime

Lista e shkurtimeve të përdorura në këtë CCU është si në vijim:

- ACE: Gabim i Zonës së Kontrollit;
- ACER: Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë;
- ANES: programet e jashtme të bashkuara të rrjeteve;
- CCFR: rregullat e zakonshme të shlyerjes për Evropën Kontinentale për shkëmbimet e energjisë të synuara si rezultat i procesit të kontrollit të

frekuencës dhe periudhës së ndryshimit (rritje/ulje);

- CCU: rregullat e përbashkëta të shlyerjes për Evropën Kontinentale për të gjitha shkëmbimet e energjisë të paqëllimshme;

- EBGL: Rregullorja e Komisionit (BE) 2017/2195, e 23 nëntorit 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike;

- Rregullorja e Energjisë Elektrike: Rregullorja (EC) nr. 714/2009, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 13 korrik 2009, mbi kushtet për akses në rrjet për shkëmbimet ndërkufitare të energjisë elektrike;

- Zona LFC: zona e kontrollit të frekuencës së ngarkesës;

- Blloku LFC: blloku i kontrollit të frekuencës së ngarkesës;

- SA CE: Zona Sinkronike e Evropës Kontinentale;

- SOGL: Rregullorja (KE) nr. 2017/1485, e datës 2 gusht 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike;

- TSO: Operatori i Sistemit të Transmetimit,

Neni 1

Objekti dhe qëllimi

1. Rregullat e zakonshme të shlyerjes për të gjitha shkëmbimet e paqëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të kontrollit të frekuencës dhe periudhës së ndryshimit (rritje/ulje) siç përcaktohet në këtë CCFR është propozimi i përbashkët i të gjithë TSO-ve të SA CE, në përputhje me nenin 50 (3) të EBGL-së.

2. Rregullat e mëposhtme të shlyerjes janë jashtë fushëveprimit të CCFR:

a) rregullat e përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë në pajtim me nenin 50 (1) të EBGL-së;

b) rregullat e përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë në pajtim me nenin 50 (4) të EBGL-së;

c) rregullat e përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e paqëllimshëm të energjisë në përputhje me nenin 51 (1) të EBGL-së;

d) rregullat e përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e paqëllimshëm të energjisë në përputhje me nenin 51 (2) të EBGL-së;

3. Qeverisja, ndarja e kostos dhe vendimmarrja do të organizohen sipas kërkesave të EBGL-së, por nuk janë brenda fushëveprimit të kësaj CCFR.

Neni 2

Përkufizime dhe interpretime

1. Për qëllimet e kësaj CCFR-je, termat e përdorur do të kenë përkufizimet që u janë dhënë atyre në nenin 2 të EBGL-së dhe në nenin 3 të SOGL-së.

2. Përveç kësaj, në këtë CCFR do të zbatohen kushtet e mëposhtme:

a) CCU-ja i referohet ‘Të gjitha propozimeve të TSO-ve kontinentale evropiane për rregullat e shlyerjeve të përbashkëta për të gjitha shkëmbimet e energjisë të paqëllimshme në përputhje me nenin 51 (1), të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, të 23 nëntorit 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike

b) ‘Energji e procesit të kontrollit të frekuencës’ nënkupton energjinë që është importuar ose eksportuar nga çdo zonë LFC-je për periudhën e shlyerjes TSO–TSO në përputhje me procesin e kontrollit të frekuencës sipas nenit 142 të SOGL-së. Energjia e procesit të kontrollit të frekuencës është e barabartë me integralin e gabimit të kontrollit të frekuencës sipas nenit 3 të SOGL-së mbi një periudhë shlyerje TSO–TSO dhe korrespondon me shkëmbimet e qëllimshme të energjisë sipas nenit 50 (3) (a) të EBGL-së;

c) ‘Energji e periudhës së ndryshimit (rritje/ulje)’ domethënë shkëmbimet e qëllimshme

të energjisë sipas nenit 50 (3) (b) të EBGL-së dhe nenit 136 të SOGL-së;

d) ‘Periudha e shlyerjes TSO–TSO’ nënkupton, në kontekstin e kësaj CCFR, njësinë e kohës për të cilën llogariten shkëmbimet e paqëllimshme dhe të shkëmbimeve të qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të kontrollit të frekuencës dhe periudhës së ndryshimit (rritje/ulje);

e) ‘shkëmbimet e paqëllimshme të energjisë’ janë të barabarta me integralin e gabimit të zonës së kontrollit (ACE) sipas nenit 3 të SOGL-së mbi periudhën e shlyerjes TSO–TSO.

3. Në këtë CCFR, me përjashtim të rastit kur konteksti kërkon të kundërtën:

a) çmimet për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë jepen në EUR/mwh;

b) ‘Evropa Kontinentale’ dhe ‘SA CE’ nënkuptojnë Zonën Sinkronike të Evropës Kontinentale.

4. Gjithashtu, me përjashtim të rastit kur konteksti kërkon të kundërtën:

a) njëjësi tregon shumësin dhe anasjelltas;

b) tabela e përmbajtjeve dhe titujt vendosen vetëm për lehtësi dhe nuk ndikojnë në interpretimin e kësaj CCFR;

c) çdo referencë në legjislacion, rregullore, direktivë, urdhër, instrument, kod ose ndonjë akt tjetër do të përfshijë çdo modifikim, zgjatje ose rimirimit të tij në fuqi.

5. Shlyerja sipas nenit 3 (8) dhe 3 (9) të kësaj CCFR duhet të përputhet me konventën e shenjave në tabelën 1:

Tabela 1. Drejtimi i pagesës për shlyerjen e TSO-së sipas CCFR

	Çmimi i shlyerjes TSO–TSO: pozitiv	Çmimi i shlyerjes TSO–TSO: negativ
Vëllimi i shlyerjes së TSO-ve: pozitiv (eksportet e TSO-ve)	Pagesa për TSO-të	Pagesa nga TSO-të
Vëllimi i shlyerjes së TSO-ve: negativ (importet e TSO-ve)	Pagesa nga TSO-të	Pagesa për TSO-të

Neni 3

Projekti i nivelit të lartë për zgjidhjen e përbashkët

1. Shlyerja e përbashkët e kryer nga TSO-të e SA CE në pajtim me këtë CCFR do të përbëhet nga funksioni i Llogaritjes së energjisë në kufi, funksioni i shlyerjes së CCFR dhe detyra e faturimit.

2. Njësia ose subjektet e ngarkuara me funksionin të llogaritjes së energjisë në kufi të CCFR do të mbledhin të gjitha të dhënat e kërkuara për të llogaritur vlerat e procesit të kontrollit të frekuencës së energjisë dhe periudhën e ndryshimit (rritje/ulje) për secilën periudhë shlyerje TSO–TSO.

3. Inputet në funksionin e llogaritjes së energjisë në kufi të CCFR do të jenë:



a) Vlera e njoftuar e faktorit-k për zonën LFC të SA CE;

b) Devijimi mesatar i frekuencës për çdo periudhë shlyerje TSO–TSO të SA CE, i cili do të përcaktohet nga TSO-të e caktuar;

c) të gjitha skedulet e jashtëm të netuar dhe agreguar (ANES) brenda SA CE.

4. Rezultati i funksionit të llogaritjes së energjisë në kufi të CCFR do të jetë:

a) shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i periudhës së ndryshimit (rritje/ulje) për çdo periudhë shlyerje TSO–TSO brenda SA CE;

b) shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të kontrollit të frekuencës për çdo periudhë shlyerje TSO–TSO brenda SA CE.

5. Njësia ose njësitet të cilave u është besuar funksioni i shlyerjes CCFR do të mbledhë të gjitha të dhënat e kërkuara për të llogaritur një çmim të shkëmbimit të procesit të kontrollit të frekuencës së energjisë dhe periudhës së ndryshimit (rritje/ulje) për çdo periudhë shlyerje TSO–TSO dhe do të llogarisë rezultatin financiar dhe fluksin financiar për çdo bllok LFC-je ose zonë LFC-je.

6. Inputi i funksionit të shlyerjes CCFR do të jetë:

a) vëllimet e shkëmbimit të energjisë të qëllimshme si rezultat i procesit të kontrollit të frekuencës dhe periudhës së ndryshimit (rritje/ulje) në përputhje me nenin 7 të CCU;

b) çmimin e tregut për ditën e ardhshme të çdo blloku LFC në SA CE në përputhje me nenin 8 (2) (a) të kësaj CCFR;

c) devijimin mesatar të frekuencës për secilën periudhë të shlyerjes TSO–TSO të SA CE e cila përcaktohet nga një TSO e caktuar;

d) volumet e shkëmbimeve të paqëllimshme në përputhje me nenin 7 të kësaj CCFR.

7. Funksioni i shlyerjes CCFR do të llogarisë rezultatet vijuese:

a) Çmimin për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të kontrollit të frekuencës për çdo periudhë shlyerje TSO–TSO;

b) flukset financiare ndërmjet të gjitha blloqeve LFC ose zonave të LFC-së në SA CE si rezultat i shkëmbimit të qëllimshme të energjisë së procesit të kontrollit të frekuencës për çdo periudhë shlyerje TSO–TSO.

8. Të gjitha vëllimet e energjisë së periudhës së ndryshimit (rritje/ulje) të llogaritura për çdo bllok

LFC-je ose zonë LFC-je për çdo periudhë shlyerje TSO–TSO, në përputhje me nenin 7 të kësaj CCFR, do të shlyhen me të njëjtin çmim të llogaritur për atë periudhë shlyerje TSO–TSO, në përputhje me nenin 8 (1) të kësaj CCFR.

9. Të gjitha vëllimet e energjisë të procesit të kontrollit të frekuencës të llogaritura për çdo bllok LFC-je ose zonë LFC-je për çdo periudhë shlyerje TSO–TSO, në përputhje me nenin 7 të kësaj CCFR-je, do të shlyhen me të njëjtin çmim të llogaritur për atë periudhë shlyerje TSO–TSO, në përputhje me nenin 8 (2) të kësaj CCFR.

10. Shlyerja do të realizohet në nivelin e zonave LFC përveç nëse:

a) të gjitha TSO-të e një blloku të vetëm LFC-je bien dakord për shlyerje në nivel të bllokut LFC; ose

b) disa TSO të një blloku të vetëm LFC-je bien dakord për shlyerjen e përbashkët të zonës së tyre LFC.

11. Njësia ose njësitet të cilave u është besuar detyra e faturimit duhet t'i faturojnë TSO-ve SA CE sipas rezultateve të funksionit të zgjidhjes CCFR.

12. Të gjitha TSO-të e SA CE pranojnë flukset financiare dhe janë të detyruar të paguajnë sipas tyre. Flukset financiare duhet të rishikohen në rast se gjendet një gabim në llogaritjet ose në të dhënat e vendosura në llogaritje.

Neni 4

Zbatimi i zgjidhjes së përbashkët

1. Të gjitha TSO-të e SA CE zbatojnë rregullat e përbashkëta të shlyerjes brenda 12 muajve pas miratimit të kësaj CCFR, në përputhje me nenin 5 (5) të EBGL-së.

2. Hapat e mëposhtëm dhe afatet kohore do të përdoren si udhërrëfyes për zbatimin e rregullave të përbashkëta të shlyerjes:

a) adaptimi i të gjithë matësve: të gjithë TSO-të e SA CE kanë ndryshuar pajisjet matëse të tyre dhe janë në gjendje të matin shkëmbimet e energjisë në periudhën e shlyerjes TSO–TSO;

b) emërimi i subjekteve: funksioni i llogaritjes së energjisë në kufi të CCFR, funksioni i zgjidhjes së CCU-së dhe detyrat e faturimit janë emëruar në një ose disa njësi sipas nenit 3 të CCU-së;



c) zbatimi i funksionit të llogaritjes së energjisë në kufi të CCFR: Njësia ose njësitë të cilave u është besuar funksioni i llogaritjes së energjisë në kufi të CCFR. Të gjithë TSO-të e SA CE do të zbatojnë ndërfaqet e tyre me funksionin e llogaritjes së energjisë në kufi të CCFR nëse është e nevojshme;

d) zbatimi i funksionit të shlyerjes së CCFR: Njësia ose njësitë të cilave u është besuar funksioni i shlyerjes së CCFR duhet të zbatojnë funksionin e shlyerjes CCFR. Të gjithë TSO-të e SA CE do të zbatojnë ndërfaqet e tyre me funksionin e shlyerjes të CCFR nëse është e nevojshme;

e) zbatimi i detyrave të faturimit të CCFR: Njësia ose njësitë të cilave u është besuar detyra e faturimit të CCFR-së duhet të zbatojnë detyrat e faturimit të CCFR. Do të konfigurohen të gjitha ndërfaqet e nevojshme;

f) testimi: të gjitha TSO-të e SA CE do të testojnë ndërfaqet në Llogaritjen e energjisë në kufi CCFR, funksionin e shlyerjes CCFR dhe, nëse është e zbatueshme, në detyrat e faturimit CCU;

g) kohë reale: nëse të gjitha testimet në përputhje me nenin 4 (2) (f) të kësaj CCFR do të jenë të suksesshme, shlyerja e përbashkët do të vazhdojë në kohë reale;

h) mekanizmi i rishikimit: pas implementimit të këtyre rregullave të përbashkëta të shlyerjes, një mekanizëm shqyrtimi fillon nga fundi i vitit 2022, në të cilin TSO-të e SA CE do të shqyrtojnë CCFR. Një rishikim do të bëhet të paktën çdo tre vjet pas shqyrtimit të parë të duhur deri në fund të vitit 2022. Në mekanizmin e rishikimit, do të vlerësohet mundësia për evoluimin e çmimeve të balancimit në vend të çmimeve të tregut të ditës së ardhshme. Përveç kësaj, mekanizmi i rishikimit mund të prekë, për shembull, parametrat e rregullave të çmimeve të përshkruara në nenin 8 të kësaj CCFR, por edhe detaje teknike si grumbullimi i të dhënave. Çdo ndryshim në CCFR duhet të dorëzohet nga autoritetet përkatëse rregullatore për miratim.

3. Të gjitha funksionet e shlyerjes në pajtim me nenet 19–22 të EBGL-së do të marrin parasysh se vëllimet e shkëmbimeve të qëllimshme energjisë mund të duhet të dorëzohen në një zgjidhje tjetër kohore nëse ndryshohet periudha e shlyerjes TSO–TSO për energjinë e procesit të kontrollit të frekuencës dhe ndryshimit (rritje/ulje) të energjisë.

Neni 5

Funksionet e shlyerjes së përbashkët

1. Shlyerja e përbashkët në pajtim me këtë CCFR do të përbëhet nga funksioni i llogaritjes së energjisë në kufi i CCFR dhe funksioni i shlyerjes së CCFR.

2. Qëllimi i funksionit të Llogaritjes së energjisë në kufi të CCFR do të jetë llogaritja e shkëmbimeve të qëllimshme të energjisë si rezultat i periudhës së ndryshimit (rritje/ulje) dhe procesit të kontrollit të frekuencës, për çdo periudhë shlyerje TSO–TSO brenda SA CE, në përputhje me nenin 3 të kësaj CCFR.

3. Qëllimi i funksionit të shlyerjes së CCFR është llogaritja e çmimit të shkëmbimeve të qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të kontrollit të frekuencës për çdo periudhë të shlyerjes TSO–TSO dhe të flukseve financiare midis të gjitha blloqeve LFC ose zonave LFC në SA CE si rezultat i shkëmbimeve të qëllimshme të energjisë së procesit të kontrollit të frekuencës, në përputhje me nenin 3 të kësaj CCFR.

Neni 6

Periudha e shlyerjes

1. Periudha e shlyerjes TSO–TSO është caktuar të jetë 15 minuta.

2. Periudha e shlyerjes TSO–TSO të çdo dite fillon menjëherë pas orës 00:00. Periudhat e shlyerjes TSO–TSO do të jenë të njëpasnjëshme dhe jo të mbivendosura.

Neni 7

Përcaktimi i volumit për periudhën e shlyerjes TSO–TSO

1. Vëllimet e shkëmbimeve të qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të kontrollit të frekuencës sipas nenit 50 (3) (a) të EBGL-së, llogariten nga funksioni i llogaritjes së energjisë në kufi i CCFR, për secilin bllok LFC-je ose zonë LFC-je për çdo periudhë shlyerje TSO–TSO, si produkt i faktorit k të njohur dhe devijimit mesatar të frekuencës për atë periudhë shlyerje TSO–TSO, në përputhje me nenin 3 të kësaj CCFR-je.

2. Vëllimet e shkëmbimeve të qëllimshme të energjisë si rezultat i periudhës së ndryshimit (rritje/ulje) sipas nenit 50 (3) (b) të EBGL-së dhe nenit 136 të SOGL-së, llogariten me anë të funksionit të Llogaritjes së energjisë në kufi të CCFR-së për çdo bllok LFC-je ose zonë LFC-je



dhe për periudhën e shlyerjes TSO–TSO, në përputhje me nenin 136 të SOGL-së.

3. Vëllimet e shkëmbimeve të paqëllimshme sipas nenit 51 (1) të EBGL-së, llogaritet me anë të funksionit të llogaritjes së energjisë në kufi CCU, për çdo bllok LFC-je ose zonë LFC-je dhe për periudhën e shlyerjes TSO–TSO, në përputhje me CCU-në.

Neni 8

Rregullat e tarifimit për shkëmbimet TSO–TSO brenda SA CE

1. Çmimi për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i periudhës së ndryshimit (rritje/ ulje) sipas nenit 50 (3) (b) të EBGL-së është zero (0) EUR/mwh.

2. Çmimi për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë në përputhje me nenin 50 (3) (a) të EBGL-së do të llogaritet nga njësia të cilës i është besuar funksioni i shlyerjes CCFR si shumë e elementeve vijuese në EUR/mwh, për periudhën e shlyerjes TSO–TSO:

a) një komponent i çmimit referues i llogaritur për çdo periudhë të caktuar të shlyerjes TSO–TSO si çmim mesatar i ponderuar i tregut të ditës së mëparshme të të gjitha blloqeve LFC brenda SA CE për atë periudhë të shlyerjes TSO–TSO, e matur me vlerën absolute të shumës së shkëmbimeve të qëllimshme të energjisë në përputhje me nenin 50 (3) (a) të EBGL-së dhe shkëmbimeve të paqëllimshme të energjisë sipas nenit 51 (1) të EBGL-së, të secilit bllok LFC-je;

b) do të zbatohen rregullat e mëposhtme:

i. në rast se ka më shumë se një çmim të tregut të një dite më parë për bllokun LFC për atë periudhë të shlyerjes TSO–TSO, çmimi mesatar i ponderuar llogaritet nga njësia të cilës i është besuar funksioni i shlyerjes dhe përdoret në 8 (2) (a) për bllokun përkatës LFC. Çmimi mesatar i ponderuar i një blloku LFC llogaritet duke ponderuar çmimet e tregut të ditës së mëparshme të zonave LFC në atë bllok LFC-je me faktorin përkatës k të njoftuar të secilës zonë LFC-je. Nëse nuk ka çmim të tregut për një ditë më parë në një zonë LFC-je brenda bllokut LFC, kjo zonë LFC-je nuk konsiderohet për llogaritjen e çmimit mesatar të ponderuar të bllokut LFC;

ii. në rast se ka më shumë se një çmim të tregut të një dite më parë në një zonë LFC-je për atë periudhë të shlyerjes TSO–TSO, TSO-të që vepron

në zonën LFC mund të vendosë se cilin çmim ose çmime do të përdorë për përcaktimin e çmimit të tregut të ditës së mëparshme të zonës LFC;

iii. në rast se nuk ka një çmim të tregut të ditës së mëparshme në një bllok LFC-je për atë periudhë të caktuar të shlyerjes TSO–TSO, çmimi i shlyerjes së disbalancave për atë bllok LFC-je për atë periudhë të caktuar të shlyerjes TSO–TSO përdoret në nenin 8 (2) (a) në vend të një çmimi të tregut për një ditë më parë. Në rastin e çmimeve të dyfishta, llogaritet një çmim mesatar;

b) një komponent i varur nga frekuenca, i zbatueshëm vetëm nëse vlera absolute e devijimit mesatar të frekuencës mbi periudhën e shlyerjes TSO–TSO tejkalon vlerën absolute të vlerës minimale të pragut (20 mHz). Komponenti i varur nga frekuenca llogaritet si funksion i devijimit mesatar të frekuencës për secilën periudhë të shlyerjes TSO–TSO, duke përdorur një gradient ndërmjet kufirit minimal dhe pragut maksimal (dy (2) EUR/mwh/mHz). Do të zbatohen rregullat e mëposhtme:

i. vlera absolute e vlerës minimale të pragut është 20 mHz;

ii. vlera absolute e vlerës maksimale të pragut është 100 mHz;

iii. gradienti është dy (2) EUR/mwh /mHz;

iv. në rast të një devijimi mesatar pozitiv të frekuencës që tejkalon vlerën minimale të pragut në drejtim pozitiv (+20 mHz), por që nuk tejkalon vlerën maksimale të pragut në drejtim pozitiv (+100 mHz), ky funksion zbatohet për devijimin mesatar të frekuencës të zvogëluar me vlerën absolute të vlerës minimale të pragut (20 mHz);

v. në rast të një devijimi mesatar negativ të frekuencës që tejkalon vlerën minimale të pragut në drejtim negativ (-20 mHz), por që nuk tejkalon vlerën maksimale të pragut në drejtim negativ (-100 mHz), ky funksion aplikohet në devijimin e frekuencës të rritur me vlerën absolute të vlerës minimale të pragut (20 mHz);

vi. në rastin e një devijimi mesatar pozitiv të frekuencës që tejkalon pragun maksimal në drejtim pozitiv (+100 mHz), komponenti i varur nga frekuenca vendoset si komponent i varur nga frekuenca e llogaritur në një devijim të frekuencës së vlerës maksimale të pragut në drejtim pozitiv (+100 mHz);

vii. në rastin e një devijimi negativ të frekuencës që tejkalon pragun maksimal në drejtim negativ (-



100 mHz), komponenti i varur nga frekuenca përcaktohet si komponent i varur nga frekuenca e llogaritur në një devijim të frekuencës së vlerës së pragut maksimal në drejtim negativ (-100 mHz);

viii. në rastin e një sistemi HVDC që lidh dy TSO-të SA CE, komponenti i varur nga frekuenca mund të mos jetë i zbatueshëm.

3. Në rast se një ndarje të rrjetit me më shumë se një bllok LFC-je shkëputet, komponenti i varur nga frekuenca përcaktohet për çdo periudhë shlyerje TSO–TSO gjatë asaj ndarje në zero (0) EUR/mwh/mHz për periudhën e shlyerjes TSO–TSO.

Neni 9

Botimi dhe zbatimi i CCFR

1. Të gjithë TSO-të e SA CE do të publikojnë CCFR-në pa vonesa të panevojshme pasi të gjitha autoritetet rregullatore relevante të SA CE të kenë miratuar CCFR e propozuar ose është marrë një vendim nga ACER-i, në përputhje me nenet 5 (7), 6 (1) dhe 6 (2) të EBGL-së.

2. Të gjitha TSO-të e SA CE duhet të zbatojnë CCFR-në në përputhje me nenin 4 të kësaj CCFR-në.

Neni 10

Gjuha

Gjuha e referencës për këtë propozim do të jetë gjuha angleze. Për shmangien e dyshimit, kur TSO-të duhet të përkthejnë këtë propozim në gjuhën e tyre kombëtare, në rast të mospërputhjeve midis versionit anglisht të botuar nga TSO-të, në përputhje me nenin 7 të EBGL-së, dhe çdo versioni në një gjuhë tjetër, TSO-të, në përputhje me legjislacionin kombëtar, do t'u sigurojnë autoriteteve përkatëse kombëtare rregullatore një përkthim të përditësuar të propozimit.

Të gjitha propozimet e TSO-ve kontinentale evropiane për rregullat e shlyerjeve të përbashkëta, për të gjitha shkëmbimet e energjisë të paqëllimshme, në përputhje me nenin 51 (1), të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, të 23 nëntorit 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike

9 maj 2019

Përmbajtja
Parathënie
Shkurtime

Neni 1: Objekti dhe qëllimi

Neni 2: Përkufizime dhe interpretime

Neni 3: Projekti i nivelit të lartë për zgjidhjen e përbashkët

Neni 4: Zbatimi i zgjidhjes së përbashkët

Neni 5: Funksionet e shlyerjes së përbashkët

Neni 6: Periudha e shlyerjes

Neni 7: Përcaktimi i volumit për periudhën e shlyerjes TSO–TSO

Neni 8: Rregullat e tarifimit për shkëmbimet TSO–TSO brenda SA CE

Neni 9: Botimi dhe zbatimi i CCU

Neni 10: Gjuha

Të gjitha TSO-të e Evropës Kontinentale, marrin në konsideratë sa më poshtë vijon:

Parathënie

1. Ky dokument është një propozim i përbashkët i zhvilluar nga të gjithë Operatorët e Sistemit të Transmisionit në Zonën Sinkronike të Evropës Kontinentale (në vijim referuar si “TSO-të e CE-së”) në lidhje me zhvillimin e rregullave të përbashkëta të shlyerjes për të gjitha shkëmbimet e energjisë të paqëllimshme (në tekstin e mëposhtëm “shkëmbime të paqëllimshme”) në përputhje me nenin 51 (1) të rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, të 23 nëntorit 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike (në tekstin e mëposhtëm “EBGL”). Ky propozim më poshtë quhet “CCU”, i cili nënkupton ‘rregullat e përbashkëta të shlyerjes për Evropën Kontinentale për të gjitha shkëmbimet e paqëllimshme të energjisë’

2. Kjo CCU merr parasysh parimet dhe qëllimet e përgjithshme të përcaktuara në EBGL, si dhe Rregulloren (EC) nr. 714/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 13 korrik 2009, mbi kushtet e aksesit në rrjet për shkëmbimet ndërkufitare të energjisë elektrike (më poshtë “Rregullorja për Energjinë Elektrike”), si dhe Rregullorja (KE) nr. 2017/1485, e datës 2 gusht 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike (më poshtë referuar si “SOGI”). Qëllimi i EBGL-së është integrimi i tregjeve të balancimit të energjisë. Integrimi i tregjeve të balancimit të energjisë duhet të lehtësohet me krijimin e platformave të përbashkëta evropiane për operimin e procesit të netimit të disbalancave dhe mundësimin e shkëmbimit të energjisë balancuese nga rezervat e



restaurimit të frekuencave dhe rezervat zëvendësuese. Bashkëpunimi midis TSO-ve duhet të kufizohet rreptësisht në atë që është e nevojshme për projektimin, zbatimin dhe funksionimin efikas dhe të sigurt të këtyre platformave Evropiane.

3. Nenet 51 (1), 51 (3) dhe 51 (4) përcakton afatin për dorëzimin e CCU-së tek autoritetet përkatëse rregullatore dhe disa kërkesa specifike për përmbajtjen e tyre:

“1. Deri në tetëmbëdhjetë muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, të gjithë TSO-të e një zone sinkron do të zhvillojnë një propozim për rregullat e përbashkëta të shlyerjes të zbatueshme për të gjitha shkëmbimet e energjisë e paqëllimshme. Propozimi duhet të përfshijë kërkesat e mëposhtme:

a) çmimi për shkëmbimet e paqëllimshme të energjisë të tërhequr nga zona sinkron do të pasqyrojë çmimet për energjinë balancuese të aktivizuar lart për procesin e restaurimit të frekuencave ose procesin e zëvendësimit të rezervës për këtë zonë sinkron;

b) çmimi për shkëmbimet e paqëllimshme të energjisë të injektuara në zonën sinkron do të pasqyrojë çmimet për energjinë balancuese të aktivizuar në rënie për procesin e restaurimit të frekuencës ose procesin e zëvendësimit të rezervës për këtë zonë sinkron;

2. Propozimet e rregullave të përbashkëta të shlyerjes së shkëmbimeve të paqëllimshme të energjisë ndërmjet TSO-ve do të sigurojnë shpërndarje të drejtë dhe të barabartë të kostove dhe përfitimeve ndërmjet tyre.

3. Të gjitha TSO-të do të krijojnë një mekanizëm të koordinuar për rregullimet e shlyerjeve ndërmjet tyre.”.

4. CCU-ja kontribuon në objektivin e mosdiskriminimit dhe transparencës në balancimin e tregjeve në pajtim me nenin 3 (1) (a) dhe nenin 3 (2) (a) dhe 3 (2) (b) të EBGL-së, të njëjtat rregulla të shlyerjes do të zbatohen në të gjithë Zonën Sinkronike të Evropës Kontinentale dhe ato do të jenë në dispozicion të publikut.

5. CCU-ja kontribuon në objektivin e rritjes së efikasitetit të tregjeve Evropiane dhe kombëtare të balancimit, në përputhje me nenin 3 (1) (b) të EBGL-së, duke qenë se programi i kompensimit zëvendësohet me rregullat e përbashkëta të shlyerjes të zbatueshme për të gjithë Zonën Sinkronike të Evropës Kontinentale.

6. CCU-ja i shërben kërkesës së nenit 3 (2) (h) të EBGL-së duke qenë se kuadri teknik i propozuar bazohet në standardet evropiane të miratuara që tashmë janë në veprim.

7. CCU-ja u zhvillua duke marrë parasysh konsistencën me rregullat e shlyerjes së shkëmbimeve të energjisë të synuara si rezultat i procesit të kontrollit të frekuencave dhe periudhës së ndryshimit (rritje/ulje) brenda Zonës Sinkronike të Evropës Kontinentale në përputhje me nenin 50 (3) të EBGL-së.

8. CCU-ja u zhvillua duke marrë parasysh konsistencën me rregullat e shlyerjes së shkëmbimeve të synuara midis zonave sinkronike në përputhje me nenin 50 (4) të EBGL-së dhe shkëmbimet e paqëllimshme në përputhje me nenin 51 (2) të EBGL-së.

9. Në përfundim, CCU-ja kontribuon në objektivat e përgjithshme të EBGL-së.

Shkurtime

Lista e shkurtimeve të përdorura në këtë CCU është si në vijim:

- ACE: Gabim i zonës së kontrollit;
- ACER: Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë;
- ANES: programet e jashtme të bashkuara të rrjeteve;
- CCFR: rregullat e zakonshme të shlyerjes për Evropën Kontinentale, për shkëmbimet e energjisë të synuara si rezultat i procesit të kontrollit të frekuencës dhe periudhës së ndryshimit (rritje/ulje);
- CCU: rregullat e përbashkëta të shlyerjes për Evropën Kontinentale për të gjitha shkëmbimet e energjisë të paqëllimshme;
- EBGL: Rregullorja e Komisionit (BE) 2017/2195, e 23 nëntorit 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike;
- Rregullorja e energjisë elektrike: rregullorja (EC) nr. 714/2009, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 13 korrik 2009, mbi kushtet për akses në rrjet për shkëmbimet ndërkufitare të energjisë elektrike;
- Zona LFC: zona e kontrollit të frekuencës së ngarkesës;
- Blloku LFC: blloku i kontrollit të frekuencës së ngarkesës;

- SA CE: zona sinkronike e Evropës Kontinentale;
- SOGL: Rregullorja (KE) nr. 2017/1485, e datës 2 gusht 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike;
- TSO: Operatori i Sistemit të Transmetimit.

Neni 1

Objekti dhe qëllimi

1. Rregullat e zakonshme të shlyerjes për të gjitha shkëmbimet e paqëllimshme të energjisë, siç përcaktohen në këtë CCU, janë propozim i përbashkët i të gjithë TSO-ve të SA CE-së, në përputhje me nenin 51 (1) të EBGL-së.

2. Rregullat e mëposhtme të shlyerjes janë jashtë fushëveprimit të CCU-së:

a) rregullat e përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimet e energjisë së qëllimshme, në pajtim me nenin 50 (1) të EBGL-së;

b) rregullat e përbashkëta të shlyerjes për të gjitha shkëmbimet e qëllimshme të energjisë, në pajtim me nenin 50 (3) të EBGL-së;

c) rregullat e përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë, në përputhje me nenin 50 (4) të EBGL-së;

d) rregullat e përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e paqëllimshëm të energjisë, në përputhje me nenin 51 (2) të EBGL-së.

3. Qeverisja, ndarja e kostos dhe vendimmarrja do të organizohen sipas kërkesave të EBGL-së, por nuk janë brenda fushëveprimit të kësaj CCU-je.

Neni 2

Përkufizime dhe interpretime

1. Për qëllimet e kësaj CCU-je, termat e përdorur do të kenë përkufizimet që u janë dhënë atyre në nenin 2 të EBGL-së dhe në nenin 3 të SOGL-së.

2. Përveç kësaj, në këtë CCU do të zbatohen kushtet e mëposhtme:

a) “Të dhënat e llogaritjes së energjisë në kufi” janë rezultat i një marrëveshjeje ndërmjet dy TSO-

ve, në lidhje me energjinë fizike të shkëmbyer mbi një linjë fizike ose që konsiderohet nëpërmjet një linje lidhëse virtuale dhe rrjedh nga të dhënat e matura të vlerësuar;

b) “CCFR” i referohet ‘Të gjitha propozimeve të TSO-ve kontinentale evropiane për rregullat e shlyerjeve të përbashkëta, për të gjitha shkëmbimet e energjisë së paqëllimshme si rezultat i procesit të kontrollit të frekuencave dhe periudhës së ndryshimit (rritje/ulje), në përputhje me nenin 50 (3), të rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, të 23 nëntorit 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike’;

c) “Periudha e shlyerjes TSO–TSO” do të thotë, në kontekstin e kësaj CCU-je, njësi kohore për të cilën llogaritet shkëmbimi i paqëllimshëm i energjisë dhe shkëmbimet e energjisë, të synuara si rezultat i procesit të kontrollit të frekuencës dhe periudhës së ndryshimit (rritje/ulje);

d) “Shkëmbimet e paqëllimshme të energjisë” janë të barabarta me integralin e gabimit të zonës së kontrollit (ACE), sipas nenit 3 të SOGL-së mbi një periudhë shlyerjeje TSO–TSO.

3. Në këtë CCU, përveç nëse konteksti kërkon ndryshe:

a) çmimet për shkëmbimet e energjisë së paqëllimshme tregohen në EUR/mwh;

b) “Evropa kontinentale” dhe “SA CE” nënkuptojnë Zonën Sinkronike të Evropës Kontinentale.

4. Përveç kësaj, nëse konteksti e kërkon ndryshe:

a) njëjësi tregon shumësin dhe anasjelltas;

b) tabela e përmbajtjeve dhe titujt vendosen vetëm për lehtësi dhe nuk ndikojnë në interpretimin e kësaj CCU-je;

c) çdo referencë në legjislacion, rregullore, direktivë, urdhër, instrument, kod ose ndonjë akt tjetër do të përfshijë çdo modifikim, zgjatje ose rimiratim të tij në fuqi.

5. Shlyerja sipas nenit 3 (9), të kësaj CCU-je, duhet të ndjekë konventën e shenjave në tabelën 1

Tabela 1. Drejtimi i pagesës për shlyerjen e TSO-së sipas CCU-së

	Çmimi i shlyerjes TSO–TSO: pozitiv	Çmimi i shlyerjes TSO–TSO: negativ
Vëllimi i shlyerjes së TSO-së: pozitiv (eksportet e TSO-së)	Pagesa për TSO-të	Pagesa nga TSO-të
Vëllimi i shlyerjes së TSO-së: negativ (importet e TSO-së)	Pagesa nga TSO-të	Pagesa për TSO-të



Neni 3

**Projekti i nivelit të lartë
për zgjidhjen e përbashkët**

1. Shlyerja e përbashkët e kryer nga TSO-të e SA CE në pajtim me këtë CCU do të përbëhet nga funksioni i logaritjes së energjisë në kufi, funksioni i shlyerjes së CCU-së dhe detyra e faturimit.

2. Njësia ose subjektet e ngarkuara me funksionin e llogaritjes së energjisë në kufi të CCU-së do të mbledhin të gjitha të dhënat e kërkuara për të llogaritur vlerat e shkëmbimeve të paqëllimshme për secilën periudhë shlyerjeje TSO–TSO.

3. Inputet në funksionin e llogaritjes së energjisë në kufi të CCU-së do të jenë:

a) të dhënat e llogaritjes së energjisë në kufi për periudhën e shlyerjes TSO–TSO dhe për zonën e LFC të SA CE, duke përfshirë shkëmbimin e energjisë së llogaritur nëpërmjet një linje lineare virtuale;

b) të gjitha skedulet e jashtme neto të mbledhura (ANES) brenda SA CE;

c) vëllimet e shkëmbimeve të energjisë të synuara si rezultat i procesit të kontrollit të frekuencave dhe periudhës së ndryshimit (rritje/ulje) sipas nenit 50 (3) të EBGL-së.

4. Output i funksionit të llogaritjes së energjisë në kufi të CCU-së do të jetë vëllimi i shkëmbimeve të energjisë së paqëllimshme për secilën periudhë të shlyerjes TSO–TSO brenda SA CE.

5. Njësia ose njësitet të cilave u është besuar funksioni i shlyerjes së CCU-së do të mbledhë të gjitha të dhënat e kërkuara për të llogaritur një çmim të shkëmbimit të energjisë së paqëllimshme për secilën periudhë të shlyerjes së TSO–TSO dhe do të llogarisë rezultatin financiar dhe flukset financiare për çdo bllok LFC-je ose zonë LFC-je.

6. Inputi në funksionin e shlyerjes së CCU-së do të jetë:

a) vëllimet e shkëmbimit të energjisë së qëllimshme si rezultat i procesit të kontrollit të frekuencës dhe periudhës së ndryshimit (rritje/ulje), në përputhje me nenin 7 të CCFR dhe shkëmbimin e energjisë së paqëllimshme në përputhje me nenin 7 të kësaj CCU-së;

b) çmimin e tregut për ditën e ardhshme të secilës zonë LFC-je në SA CE, në përputhje me nenin 8 (1) (a) të kësaj CCU-je;

c) devijimin mesatar të frekuencës për secilën periudhë të shlyerjes TSO–TSO të SA CE-së e cila përcaktohet nga një TSO e caktuar;

Faqe | 1818

7. Funksioni i shlyerjes së CCU-së do të ketë rezultatet vijuese:

a) çmimi për shkëmbimet e energjisë së paqëllimshme për secilën periudhë të shlyerjes TSO–TSO;

b) flukset financiare ndërmjet të gjitha blloqeve LFC ose zonave të LFC-së në SA CE si rezultat i shkëmbimit të energjisë së paqëllimshme për secilën periudhë të shlyerjes TSO–TSO.

8. Të gjitha vëllimet e shkëmbimeve të energjisë së paqëllimshme të llogaritura për secilën bllok LFC-je ose zonë LFC-je për secilën periudhë të shlyerjes TSO–TSO, në përputhje me nenin 7 të kësaj CCU-je, do të shlyhen me të njëjtin çmim të llogaritur për atë periudhë të shlyerjes TSO–TSO në përputhje me nenet 8 (1) dhe 8 (2) të kësaj CCU-je.

9. Shlyerja do të realizohet në nivelin e zonave LFC, përveç nëse:

a) të gjithë TSO-të e një blloku të vetëm LFC-je bien dakord për një shlyerje të përbashkët të zonave të tyre LFC; ose

b) disa TSO të një blloku të vetëm LFC-je bien dakord për një shlyerje të përbashkët të zonave të tyre LFC.

10. Njësia ose njësitet të cilave u është besuar detyra e faturimit duhet t'i faturojnë TSO-ve të SA CE-së, sipas rezultateve të funksionit të zgjidhjes së CCU-së.

11. Të gjitha TSO-të e SA CE pranojnë flukset financiare dhe janë të detyruar të paguajnë sipas tyre. Flukset financiare duhet të rishikohen në rast se gjendet një gabim në llogaritjet ose në të dhënat e vendosura në llogaritje.

Neni 4

**Zbatimi i zgjidhjes
së përbashkët**

1. Të gjitha TSO-të e SA CE zbatojnë rregullat e përbashkëta të shlyerjes, brenda 12 muajve pas miratimit të kësaj CCU-je, në përputhje me nenin 5 (5) të EBGL-së.

2. Hapat e mëposhtëm dhe afatet kohore do të përdoren si udhërrëfyes për zbatimin e rregullave të përbashkëta të shlyerjes:

a) adaptimi i të gjithë matësve: të gjithë TSO-të e SA CE kanë ndryshuar pajisjet matëse të tyre dhe janë në gjendje të matin shkëmbimet e energjisë në periudhën e shlyerjes TSO–TSO;



b) emërimi i subjekteve: funksioni i llogaritjes së energjisë në kufi të CCU-së, funksioni i zgjidhjes së CCU-së dhe detyrat e faturimit janë emëruar në një ose disa njësi, sipas nenit 3 të kësaj CCU-je;

c) zbatimi i funksionit të llogaritjes së energjisë në kufi të CCU-së: njësia ose njësitë të cilave u është besuar funksioni i llogaritjes së energjisë në kufi të CCU-së duhet të zbatojnë funksionin e llogaritjes së energjisë në kufi të CCU-së. Të gjithë TSO-të e SA CE do të zbatojnë lidhjet e tyre me funksionin e llogaritjes së energjisë në kufi të CCU-së nëse është e nevojshme;

d) zbatimi i funksionit të shlyerjes së CCU-së: njësia ose njësitë të cilave u është besuar funksioni i shlyerjes së CCU-së duhet të zbatojnë funksionin e shlyerjes së CCU-së. Të gjithë TSO-të e SA CE duhet të zbatojnë lidhjet e tyre me funksionin e shlyerjes CCU-së nëse është e nevojshme;

e) zbatimi i detyrave të faturimit të CCU-së: njësia ose njësitë të cilave u është besuar detyra e faturimit të CCU-së duhet të zbatojnë detyrat e faturimit të CCU-së. Të gjitha lidhjet e nevojshme duhet të jenë të konfiguruar;

f) testimi: të gjithë TSO-të e SA CE do të testojnë ndërlidhjet me llogaritjen e energjisë në kufi të CCU-së, funksionin e shlyerjes së CCU-së dhe nëse është e zbatueshme, detyrën e faturimit të CCU-së;

g) kohë reale: nëse të gjitha testimet në përputhje me nenin 4 (2) (f), të kësaj CCU-je, do të jenë të suksesshme, shlyerja e përbashkët do të vazhdojë në kohë reale;

h) mekanizmi i rishikimit: pas implementimit të këtyre rregullave të përbashkëta të shlyerjes, një mekanizëm shqyrtimi fillon nga fundi i vitit 2022, në të cilin TSO-të e SA CE do të shqyrtojnë CCU-në. Një rishikim do të bëhet të paktën çdo tre vjet pas shqyrtimit të parë të duhur deri në fund të vitit 2022. Në mekanizmin e rishikimit, mundësia për evoluimin e çmimeve të balancimit në vend të çmimeve të tregut të ditës së ardhshme do të vlerësohet. Përveç kësaj, mekanizmi i rishikimit mund të prekë, për shembull, parametrat e rregullave të çmimeve të përshkruara në nenin 8, të kësaj CCU-je, por edhe detaje teknike si grumbullimi i të dhënave. Çdo ndryshim në CCU duhet të dorëzohet nga autoritetet përkatëse rregullatore për miratim.

3. Të gjitha funksionet e shlyerjes, në pajtim me nenet 19–22 të EBGL-së, do të marrin parasysh se

vëllimet e shkëmbimeve të qëllimshme të energjisë mund të duhet të dorëzohen në një zgjidhje tjetër kohore nëse ndryshohet periudha e shlyerjes TSO–TSO për shkëmbimet e energjisë së paqëllimshme.

Neni 5

Funksionet e shlyerjes së përbashkët

1. Shlyerja e përbashkët në pajtim me këtë CCU do të përbëhet nga funksioni i llogaritjes së energjisë në kufi të CCU-së dhe funksioni i shlyerjes së CCU-së.

2. Qëllimi i funksionit të llogaritjes së energjisë në kufi të CCU-së është llogaritja e shkëmbimeve të energjisë së paqëllimshme, për çdo periudhë të shlyerjes TSO–TSO brenda SA CE, në përputhje me nenin 3 të kësaj CCU-je.

3. Qëllimi i funksionit të shlyerjes së CCU-së është llogaritja e çmimit për shkëmbimin e paqëllimshëm të energjisë, për secilën periudhë të shlyerjes TSO–TSO, dhe të flukseve financiare midis të gjitha blloqeve LFC ose zonave LFC në SA CE si rezultat i shmangies së shkëmbimeve të paqëllimshme të energjisë për çdo periudhë shlyerje të TSO–TSO, në përputhje me nenin 3 të kësaj CCU-je.

Neni 6

Periudha e shlyerjes

1. Periudha e shlyerjes TSO–TSO është caktuar të jetë 15 minuta.

2. Periudha e shlyerjes TSO–TSO të çdo dite fillon menjëherë pas orës 00:00. Periudhat e shlyerjes TSO–TSO do të jenë të njëpasnjëshme dhe jo të mbivendosura.

Neni 7

Përcaktimi i volumit për periudhën e shlyerjes TSO–TSO

1). Vëllimet e shkëmbimeve të energjisë, të parashikuara në përputhje me nenet 50 (1) dhe 50 (3), të EBGL-së janë përcaktuar si më poshtë:

a) vëllimi i shkëmbimeve të qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të zëvendësimit të rezervës sipas nenit 50 (1) (a) të EBGL-së është i përfshirë në oraret e jashtme neto të mbledhura;



b) vëllimi i shkëmbimeve të qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të restaurimit të frekuencave me aktivizimin manual, sipas nenit 50 (1) (b) të EBGL-së, është i barabartë me vëllimin e raportuar në oraret e jashtme neto të mbledhura dhe/ose të dhënat e llogaritjes së energjisë në kufi nga TSO-të e zonave LFC;

c) vëllimi i shkëmbimeve të qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të restaurimit të frekuencave me aktivizim automatik, sipas nenit 50 (1) (c) të EBGL-së, është i barabartë me volumin e raportuar në të dhënat e llogaritjes së energjisë në kufi nga TSO-të e zonave LFC;

d) vëllimi i shkëmbimeve të qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të netimit të disbalancave, sipas nenit 50 (1) (d) të EBGL-së, është i barabartë me volumin e raportuar në të dhënat e llogaritjes së energjisë në kufi nga TSO-të e zonave LFC;

e) vëllimi i shkëmbimeve të qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të mbajtjes së frekuencës, sipas nenit 50 (3) (a) të EBGL-së, është llogaritur nga funksioni i llogaritjes së energjisë në kufi CCFR për secilin bllok LFC-je ose zonë LFC-je, për periudhën e shlyerjes TSO-TSO si produkti i faktorit k të njoftuar dhe devijimit të frekuencës mesatare për atë periudhë të shlyerjes TSO-TSO, në përputhje me CCFR-në;

f) vëllimi i shkëmbimeve të qëllimshme të energjisë si rezultat i periudhës së ndryshimit (rritje/ ulje), sipas nenit 50 (3) (b) të EBGL-së dhe nenit 136 të SOGL-së, është llogaritur nga funksioni i llogaritjes së energjisë në kufi të CCFR, për secilin bllok LFC-je ose zonë LFC-je dhe për periudhën e shlyerjes TSO-TSO, në pajtim me CCFR-në;

g) vëllimi i shkëmbimeve të qëllimshme të energjisë si rezultat i marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe nëpërmjet vijave virtuale, të cilat nuk mbulohen nga pikat e mëparshme, është i barabartë me volumin e raportuar në të dhënat e llogaritjes së energjisë në kufi nga TSO-të e zonave përkatëse LFC.

2. Vëllimi i shkëmbimeve të paqëllimshme të energjisë sipas nenit 51 (1) të EBGL-së, është llogaritur, për çdo bllok LFC-je ose zonë LFC-je për periudhën e shlyerjes TSO-TSO, si diferencë midis shkëmbimeve të energjisë sipas të dhënave të llogaritjes së energjisë në kufi dhe shumës së ANES-it dhe të gjitha shkëmbimeve të energjisë, të

synuara si rezultat i nenit 50 (1) dhe 50 (3) të LBGL-së dhe nenit 7 (1) të kësaj CCU-je.

Neni 8

Rregullat e tarifimit për shkëmbimet TSO-TSO brenda SA CE

1. Çmimi për shkëmbimin e energjisë së paqëllimshme, në përputhje me nenin 51 (1) të EBGL-së do të llogaritet nga njësia ekonomike e ngarkuar me funksionin e shlyerjes së CCU-së si shuma e komponentëve të mëposhtëm në EUR/mwh për periudhën e shlyerjes TSO-TSO:

a) një komponent i çmimit referues i llogaritur për çdo periudhë të caktuar të shlyerjes TSO-TSO si çmim mesatar i ponderuar i tregut të ditës së mëparshme të të gjitha blloqeve LFC brenda SA CE për atë periudhë të shlyerjes TSO-TSO, e matur me vlerën absolute të shumës së shkëmbimeve të qëllimshme të energjisë në përputhje me nenin 50 (3) (a) të EBGL-së dhe shkëmbimeve të paqëllimshme të energjisë sipas nenit 51 (1) të EBGL-së, të secilit bllok LFC-je;

Do të zbatohen rregullat e mëposhtme:

i. në rast se ka më shumë se një çmim të tregut të një dite më parë për bllokun LFC për atë periudhë të shlyerjes TSO-TSO, një çmim mesatar i ponderuar llogaritet nga njësia e cilës i është besuar funksioni i shlyerjes dhe përdoret në 8 (1) (a) për bllokun përkatës LFC. Çmimi mesatar i ponderuar i një blloku LFC llogaritet duke ponderuar çmimet e tregut të ditës së mëparshme të zonave LFC, në atë bllok LFC-je, me faktorin përkatës k të njoftuar të secilës zonë LFC-je. Nëse nuk ka çmim të tregut për një ditë më parë në një zonë LFC-je, brenda bllokut LFC, kjo zonë LFC-je nuk konsiderohet për llogaritjen e çmimit mesatar të ponderuar të bllokut LFC;

ii. në rast se ka më shumë se një çmim të tregut të një dite më parë në një zonë LFC-je, për atë periudhë të shlyerjes TSO-TSO, TSO-ja që vepron në zonën LFC mund të vendosë se cilin çmim ose çmime do të përdorë për përcaktimin e çmimit të tregut të ditës së mëparshme të zonës LFC;

iii. në rast se nuk ka një çmim të tregut të ditës së mëparshme në një bllok LFC-je për atë periudhë të caktuar të shlyerjes TSO-TSO, çmimi i shlyerjes së disbalancave, për atë bllok LFC-je, për atë periudhë të caktuar të shlyerjes TSO-TSO, përdoret në nenin 8 (1) (a), në vend të një çmimi të tregut për



një ditë më parë. Në rastin e çmimeve të dyfishta, llogaritet një çmim mesatar;

b) Një komponent i varur nga frekuenca, i zbatueshëm vetëm nëse vlera absolute e devijimit mesatar të frekuencës mbi periudhën e shlyerjes TSO–TSO tejkalon vlerën absolute të vlerës minimale të pragut (20 mHz). Komponenti i varur nga frekuenca llogaritet si funksion i devijimit mesatar të frekuencës për secilën periudhë të shlyerjes TSO–TSO, duke përdorur një pjerrësi ndërmjet kufirit minimal dhe pragut maksimal (dy (2) EUR/mwh/mHz). Do të zbatohen rregullat e mëposhtme:

i. vlera absolute e vlerës minimale të pragut është 20 mHz;

ii. vlera absolute e vlerës maksimale të pragut është 100 mHz;

iii. pjerrësia është dy (2) EUR/mwh/mHz;

iv. në rast të një devijimi mesatar pozitiv të frekuencës që tejkalon vlerën minimale të pragut në drejtim pozitiv (+20 mHz), por që nuk tejkalon vlerën maksimale të pragut në drejtim pozitiv (+100 mHz), ky funksion zbatohet për devijimin mesatar të frekuencës së zvogëluar me vlerën absolute të vlerës minimale të pragut (20 mHz);

v. në rast të një devijimi mesatar negativ të frekuencës që tejkalon vlerën minimale të pragut në drejtim negativ (-20 mHz), por që nuk tejkalon vlerën maksimale të pragut në drejtim negativ (-100 mHz), ky funksion aplikohet në devijimin e frekuencës së rritur me vlerën absolute të vlerës minimale të pragut (20 mHz);

vi. në rastin e një devijimi mesatar pozitiv të frekuencës që tejkalon pragun maksimal në drejtim pozitiv (+100 mHz), komponenti i varur nga frekuenca vendoset si komponent i varur nga frekuenca e llogaritur në një devijim të frekuencës së vlerës maksimale të pragut në drejtim pozitiv (+100 mHz);

vii. në rastin e një devijimi negativ të frekuencës që tejkalon pragun maksimal në drejtim negativ (-100 mHz), komponenti i varur nga frekuenca përcaktohet si komponent i varur nga frekuenca e llogaritur në një devijim të frekuencës së vlerës së pragut maksimal në drejtim negativ (-100 mHz);

viii. në rastin e një sistemi HVDC që lidh dy TSO-të SA CE, komponenti i varur nga frekuenca mund të mos jetë i zbatueshëm.

2. Sipas nenit 51 (1) (a) të EBGL-së, çmimi për shkëmbimin e energjisë të paqëllimshme duhet të pasqyrojë çmimin për energjinë balancuese. Sipas nenit 8 (1) (a) të kësaj CCU-je, çmimet e tregut të njëpasnjëshme, të cilat pasqyrojnë çmimet e balancimit, përdoren si një përbërës për të përcaktuar çmimin për shkëmbimet e energjisë të paqëllimshme. Të gjithë TSO-të e SA CE mund t'u propozojnë autoriteteve përkatëse rregullatore që të përdorin çmimet e balancimit në vend të çmimeve të tregut të ditës së mëparshme në përputhje me mekanizmin e rishikimit në përputhje me nenin 4 (2) (h) të kësaj CCU-je.

3. Në rast të ndarjes së rrjetit me më shumë se një bllok LFC-je të shkëputur, komponenti i varur nga frekuenca vendoset për secilën periudhë të shlyerjes TSO–TSO gjatë asaj ndarje të rrjetit në zero (0) EUR/mwh/mHz për periudhë shlyerje TSO–TSO.

Neni 9

Botimi dhe zbatimi i CCU-së

1. Të gjithë TSO-të e SA CE do të publikojnë CCU-në pa vonesa të panevojshme pasi të gjitha autoritetet rregullatore relevante të SA CE të kenë miratuar CCU-në e propozuar ose është marrë një vendim nga ACER-i, në përputhje me nenet 5 (7), 6 (1) dhe 6 (2) të EBGL-së.

2. Të gjitha TSO-të e SA CE duhet të zbatojnë CCU-në në përputhje me nenin 4 të kësaj CCU-je.

Neni 10

Gjuha

Gjuha e referencës për këtë propozim do të jetë gjuha angleze. Për shmangien e dyshimit, kur TSO-të duhet të përkthejnë këtë propozim në gjuhën e tyre kombëtare, në rast të mospërputhjeve midis versionit anglisht të botuar nga TSO-të, në përputhje me nenin 7 të EBGL-së dhe çdo versioni në një gjuhë tjetër, TSO-të, në përputhje me legjislacionin kombëtar, do t'u sigurojnë autoriteteve përkatëse kombëtare rregullatore një përkthim të përditësuar të propozimit.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 128 lekë